



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 607 Akti

Nr. 778 Vendimi
Tiranë, më 28.6.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari Kryesuese
Lulzim Hamitaj Relator
Firdes Shuli Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 25.6.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Vjollca Spahiu**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Vjollca Spahiu, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 25.6.2024 kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Vjollca Spahiu gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Znj. Vjollca Spahiu u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.12.2020 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, me trup gjykues të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Valbona Sanxhaktari dhe Firdes Shuli.
3. Në datën 21.12.2020, komisioneri Olsi Komici ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga shqyrtimi i çështjes së subjektit Vjollca Spahiu, pasi ka vlerësuar se ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit dhe bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke parashtruar arsyet e tij.
4. Me vendimin nr. ***, datë 21.12.2020, është ngritur trupi gjykues, i cili ka marrë në shqyrtim kërkesën e mësipërme. Në vijim, trupi gjykues, me vendimin nr. *** prot., datë 23.12.2020, pasi vlerësoi pretendimet dhe argumentimet e paraqitura nga komisioneri Olsi Komici, bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, si dhe në rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, miratuar me vendimin nr. ***, datë 19.7.2017, vendosi se kërkesa e tij duhej pranuar.
5. Më pas, bazuar në praktikën “Për shpërndarjen me short të çështjeve të subjekteve të rivlerësimit sipas nenit 3, pika 6, shkronja “b” e rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, nga ku ka rezultuar se për trupin gjykues nr. 1 ishte shortuar si anëtar zëvendësues komisioneri Lulzim Hamitaj, i cili në këtë rast, duke zëvendësuar komisionerin Olsi Komici, do të ishte edhe relatori i çështjes.
6. Në datën 22.1.2024, komisionerja Firdes Shuli ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga shqyrtimi i çështjes së subjektit Vjollca Spahiu, pasi ka vlerësuar se mund të ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit dhe bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke parashtruar arsyet e saj.
7. Me vendimin nr. ***, datë 23.1.2024, është ngritur trupi gjykues, i cili ka marrë në shqyrtim kërkesën e mësipërme dhe me vendimin nr. *** prot., datë 24.1.2024, pasi vlerësoi pretendimet dhe argumentimet e paraqitura nga komisionerja Firdes Shuli, bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, si dhe në rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të

- Kualifikimit”, miratuar me vendimin nr. ***, datë 19.7.2017, vendosi mospranimin e kërkesës.
8. Në datën 22.1.2024, komisionerja Valbona Sanxhaktari ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga shqyrtimi i çështjes së subjektit Vjollca Spahiu, pasi ka vlerësuar se mund të ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit dhe bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke parashtruar arsyet e saj.
 9. Me vendimin nr. ***, datë 23.1.2024, është ngritur trupi gjykues, i cili ka marrë në shqyrtim kërkesën e mësipërme, i cili me vendimin nr. *** prot., datë 24.1.2024, pasi vlerësoi pretendimet dhe argumentimet e paraqitura nga komisionerja Valbona Sanxhaktari, bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, si dhe në rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, miratuar me vendimin nr. ***, datë 19.7.2017, vendosi mospranimin e kërkesës.
 10. Në vijim, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Valbona Sanxhaktari. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
 11. Gjatë hetimit administrativ është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët (përfshirë edhe anëtarin zëvendësues), siç është përmendur më sipër. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike të datës 25.1.2021, ka konfirmuar mospasjen e ndonjë konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues që i ishin bërë me dije.
 12. Gjithashtu, ka rezultuar se në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
 - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK, në vijim AKSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
 13. Me vendimin nr. 2, datë 5.6.2024, Komisioni vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

14. Në datën 6.6.2024, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara (nëse e vlerësonte të nevojshme), në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet e kërkuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 19.6.2024.
15. Në datën 7.6.2024, subjekti u paraqit për t'u njohur me dokumentacionin, të cilin e ka administruar nëpërmjet CD-së. Më pas, subjekti paraqiti shpjegimet e veta brenda afatit të caktuar nga Komisioni.
16. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 20.6.2024, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 25.6.2024, duke e njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 25.6.2024, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.
18. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Vjollca Spahiu parashtrroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim, duke dhënë shpjegime të detajuara lidhur me gjetjet në rezultatat e njoftuara, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve që i janë drejtuar përgjatë seancës dëgjimore me shpjegimet përkatëse. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 25.6.2024 u mbyll, për të rifilluar më 28.6.2024 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës së dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLGJ-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancë dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

21. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
 - *ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë;*
 - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
22. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
23. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

1. Apartament me sipërfaqe 75 m², në Tiranë, në vlerën 3.000.000 lekë

24. Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 pasurinë e llojit apartament me nr. ***, në z. k. ***, të ndodhur në Tiranë, të përfituar sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 23.12.2003, nga shitësit S. dhe Sh. M., në vlerën 3.000.000 lekë. Shuma në fjalë është likuiduar *cash* nga subjekti dhe bashkëshorti i saj jashtë zyrës noteriale, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërsa vetë shitësi e kishte përfituar këtë pasuri në vlerën 4.250.000 lekë, sipas kontratës nr. *** datë 2.3.2000, të lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k¹.
25. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë në fjalë, si dhe burimin e krijimit të saj nga kursimet familjare ndër vite, të cilin nuk e kishte deklaruar në DIPP-në e vitit 2004. Pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i burimit në vitin 2004 ka qenë një pakujdesi nga ana e saj, pasi në atë kohë nuk dispononte ende certifikatë pronësie për këtë pasuri. Nga hetimi ka rezultuar se certifikata e pronësisë në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj është nxjerrë në datën 20.3.2015².
26. Komisioni ka përlllogaritur vlerën e apartamentit në fjalë, bazuar në çmimin e referencës sipas Udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003, të EKB-së – dhe ka konstatuar se çmimi i këtij apartamenti do të ishte rreth 4.000.000 lekë. Pasi u pyet nga Komisioni lidhur me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se bashkëshorti i saj kishte rënë në dijeni (përmes disa të njohurve) për shitjen e këtij apartamenti, për shkak të një emergjence familjare të pronarit të saj. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se me shitësit e pasurisë Sh. dhe S. M. nuk ka njohje – dhe se nuk ka gjykuar ndonjë çështje ku këta shtetas

¹ Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

² Nga dokumentacioni i administruar ASHK me shkresat nr. *** prot., datë 18.4.2018 si dhe nr. *** prot., *** prot., datë 11.5.2023, ka rezultuar se aktualisht pasuria e sipërcituar figuron e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit. Kjo pasi, me anë të kontratës së dhurimit nr. ***, datë 14.12.2020, z. S. S. i ka dhuruar pjesën e tij takuese bashkëshortes Vjollca Spahiu.

të kishin qenë palë, duke paraqitur edhe vërtetimet përkatëse³ nga gjykatat në të cilat ka ushtruar detyrën. Po ashtu, gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës⁴ është bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti ku shtetasit e mësipërm të kenë qenë palë.

27. Në mbështetje të deklarimeve të mësipërme, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës deklaraten noteriale nr. ***, datë 7.4.2023, të lëshuar nga pala shitëse, ku citohet se apartamenti është shitur në vlerën 3.000.000 lekë dhe likuidimi është bërë *cash*, si dhe një kontratë të ngjashme me nr. ***, datë 19.7.2000, për një apartament me sip. 51 m², të ndodhur në të njëjtën godinë ku ndodhet edhe pasuria në analizë, i cili është shitur në vlerën 2.500.000 lekë.
28. Gjatë hetimit administrativ, UKT-ja⁵ dhe FSHU-ja⁶ kanë konfirmuar kontrata⁷ të lidhura në emër të z. S. S., të cilat ndonëse nuk përmbajnë të dhëna të detajuara sipas adresës, përkojnë me pasurinë në analizë.

1.1 Analiza e burimeve të krijimit të shumës 3.000.000 lekë për blerjen e apartamentit në Tiranë

29. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se ajo dhe bashkëshorti dispononin kursime familjare ndër vite në shumën 2.600.000 lekë, si brenda vitit 2002 edhe të ardhurat vjetore të vitit 2003, të cilat dëshironin t'i investonin në pasuri të paluajtshme.
30. Po ashtu, subjekti ka parashtruar se në fillim të vitit 1999, bashkëshorti i saj kishte rënë dakord me z. M. Ll.⁸ të strehonte⁹ pa kundërshtim në banesën (në njërin nga dhomat e ESKUT-t), ku jetonte në atë kohë familja e saj, disa gazetarë të cilët në atë kohë raportnin ngjarje për luftën që zhvillohej në Kosovë. Pas përfundimit të luftës, rreth viteve 2002 – 2003¹⁰, z. Ll. i kishte dhënë bashkëshortit të subjektit shumën 14.600 USD, duke i shpjeguar se kjo ishte pagesa e gazetarëve për strehim. Në mbështetje të këtij deklarami, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** rep., datë 12.5.2020, nga shtetasi M. Ll., i cili ka deklaruar se në pamundësi të akomodimit të gazetarëve në ambientet e hotelit që ai dispononte, i ka strehuar ata në banesën e z. S. me konsensusin e tij, për periudhën 2002 – 2003, kundrejt pagesës në shumën 14.600 USD, shumë të cilën ia ka dorëzuar z. S. S., *cash* në vitin 2003. Po ashtu, subjekti ka vënë në dispozicion një vërtetim të datës 13.4.2003, nga shtetasi B. M., të njehsuar me origjinalin¹¹, ku citohej se ai kishte koordinuar strehimin e gazetarëve (pasi ishte drejtues i një televizioni lokal në Kukës) në banesat e disa qytetarëve, përfshirë edhe banesën e subjektit të rivlerësimit.
31. Lidhur me të ardhurat e sipër cituara, Komisioni ka konstatuar se subjekti i ka deklaruar ato si në DIPP-në e vitit 2004, po ashtu edhe në deklaraten vetting. Megjithatë, pavarësisht se gjatë hetimit administrativ subjekti saktësoi burimin e krijimit të këtyre të ardhurave nga

³ Subjekti ka paraqitur vërtetimet nr. *** prot., datë 29.3.2023 dhe nr. *** prot., datë 3.4.2023, respektivisht të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Kukës dhe Tiranë.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2023.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.8.2021. Po ashtu i njëjti institucion me shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2023, ka informuar se me gjeneralitetet e z. S. S. rezultoi kontrata nr. ***, për objektin "****", me status të pezulluar, me detyrime të palikuiduara në vlerën 13,876 lekë dhe se nuk disponohet asnjë dokumentacion që të vërtetojë që është i njëjti person.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.3.2023.

⁷ Nr. *** dhe nr. ***.

⁸ Pronari/administratori i hotel "****", në Kukës.

⁹ Sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

¹⁰ Subjekti ka pretenduar të ardhura edhe në vite të tjera, nga qiradhënia e kësaj pasurie, të cilat janë trajtuar tek analiza që përkon me periudhën 2005 – 2007.

¹¹ Me vërtetimin nr. *** datë 12.5.2020.

qiraja duke paraqitur dy vërtetime sikurse është parashtruar më sipër, deklarimi i subjektit, mbetet në nivel deklarativ dhe i pambështetur, pasi nuk u provua marrëdhënia e qirasë, vlera e përfituar nga qiraja mujore dhe as nuk rezultoi që të ishin paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

32. Për rrjedhojë, në analizë të deklarimeve të subjektit dhe provave të depozituara gjatë hetimit, duke mbajtur në konsideratë se (i) të ardhurat në fjalë nuk janë deklaruar të përdorura si burim për krijimin e ndonjë pasurie, si dhe faktin se (ii) nuk u provua me dokumentacion marrëdhënia e qirasë, vlera e përfituar nga qiraja mujore dhe as nuk rezultoi që të ishin paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi që këto të ardhura të mos i konsiderojë në analizën financiare.
33. Në vijim të sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare me të ardhurat e përfituara subjekti dhe bashkëshorti, nga viti 1995 deri në datën 23.12.2003, kur është blerë apartamenti në analizë, duke përllogaritur edhe shpenzimet dhe investimet gjatë periudhës në fjalë (në vitin 2003, blerje e një automjeti në shumën 415.800 lekë)¹², e cila u përfshi në analizën e kryer¹³. Gjithashtu, u konsideruan të gjitha të ardhurat dhe kursimet e akumuluar deri në fund të vitit 2003. Nga analiza e kryer ka rezultuar një balancë negative prej – 517.039 lekësh.
34. Nisur nga sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova/shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit lidhur me sa vijon:
- *Duket se subjekti ka pasaktësi në deklarin e kësaj pasurie, si për sa i përket vitit të deklarimit (blerë në vitin 2003, deklaruar në vitin 2004) po ashtu edhe lidhur me burimin e krijimit, i cili nuk është deklaruar në vitin 2004.*
 - *Duket se çmimi i blerjes së apartamentit ka qenë më i ulët se çmimet e referencës sipas EKB-së, si dhe nga sa e kishte përfituar vetë shitësi rreth 3 vite me parë.*
 - *Duket se të ardhurat nga qiraja për periudhën 2002 – 2003, në shumën 14.600 USD, të pretenduara nga subjekti (në këtë fazë), nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm, për sa kohë nuk u provua me dokumentacion të kohës marrëdhënia e qirasë apo pagesat e detyrimeve tatimore të tyre.*
 - *Duket se në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë në masën – 517.039 lekë.*

¹² Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar automjet tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 560.000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Në DIPP-në e vitit 2004 subjekti ka deklaruar automjet tip “Mercedes-Benz” në vlerën 800.000 lekë, me burim nga të ardhurat nga pagat. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se vlera e këtij automjeti ka qenë 2.000 euro dhe jo 800.000 lekë. Subjekti ka paraqitur faturën e shërbimit nr. 1554, datë 28.5.2002, “Për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e luajtshme (automjet)”, në shumën 2.000 euro, nga z. I. C. përkundrejt bashkëshortit të subjektit, përpara nëpunësit të DRSHTRR-së, sipas deklarimit të palëve dhe ndjekjes së procedurave të tjera për regjistrimin e mjetit. Në vitin 2014, ky automjet është nxjerrë nga qarkullimi sipas shkresës nr. *** prot., datë 13.6.2014, të DRSHTRR Tiranë dhe është shitur për skrap në shumën 100.000 lekë. Po sipas kësaj shkrese, ka rezultuar se z. C. e ka blerë automjetin nga shtetasi A. J. në vlerën 500 euro. Me anë të kontratës mbi shitjen ndërmjetësuese nr. ***, datë 25.5.2002, shitësi I. C. ja ka shitur automjetin në fjalë z. S. S. në vlerën 2.000 euro. Ky i fundit ka zhdoganuar mjetin në fjalë kundrejt pagesës në shumën 148.500 lekë në datën 27.5.2002.

¹³ Në analizë u përfshi blerja e një automjeti në vitin 2003 në vlerën totale 415.800 lekë (çmimi blerjes prej 2.000 euro dhe 148.500 lekë tarifa e zhdoganimit), si dhe investimi në një depozitë me afat në ISP prej 12.177.31 USD, depozitë kjo e tërhequr në datën 23.3.2004.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

35. Subjekti ka parashtruar se mosdeklarimi i pasurisë dhe burimit të krijimit të saj në DIPP-në e vitit 2003 ka qenë një pakujdesi e saj, për shkak se jo vetëm të faktit që deklarohet për herë të parë, por edhe për faktin se kontrata e shitblerjes është nënshkruar në fund të vitit 2003, ndërsa vërtetimi nga regjistri hipotekor që pasqyron transkriptin dhe, rrjedhimisht, përmbyll procedurën e shitblerjes, është lëshuar në janar të vitit 2004 dhe dokumenti i regjistrimit në ZVRPP është lëshuar në vitin 2004. Këto pasaktësi janë korrigjuar në deklaratën e vitit pasardhës, si dhe në deklaratën *Vetting*.
36. Lidhur me konstatimin e Komisionit se çmimi i apartamentit ka rezultuar më i ulët se ai i përlogaritur sipas çmimit të referencës sipas Entit Kombëtar të Banesave, subjekti i ka qëndruar të njëjtave shpjegime të paraqitura prej saj në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, duke ripërsëritur se blerja e apartamentit ka qenë një okazion.
37. Lidhur me të ardhurat në shumën 14.600 USD, subjekti ka pretenduar që ato të përfshihen në analizën financiare duke u konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm. Sipas subjektit, mospërfshirja e tyre në analizë ka sjellë balancën negative në masën -517.039 lekë, të konstatuar nga Komisioni. Po ashtu, subjekti ka parashtruar se për këto të ardhura ajo ka paguar tatimin lidhur me të cilin ka vënë në dispozicion të Komisionit një shkresë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë¹⁴. Sipas subjektit, rrethanat që duhet të mbahen në konsideratë nga Komisioni, në vlerësimin si të ligjshme të këtyre të ardhurave, janë si vijon: ka parashtruar se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie kontraktuale me këta shtetas/gazetarë të huaj për arsye si më poshtë:
- a) *subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë nënshkruar kontratë pasi i konsideronin miq dhe situata e luftës nuk favorizonte nënshkrimin e ndonjë kontrate apo ndonjë lloj vërtetimi;*
 - b) *nuk kanë pritur të paguheshim, pasi nuk është diskutuar paraprakisht me z. M. Ll. nëse do të jepej ndonjë shumë në të ardhmen në shenjë mirënjohjeje ndaj sakrificës për t'u ngushtuar familjarisht në një ambient të vogël;*
 - c) *pas 25 vitesh, subjekti kujton vetëm emrat dhe asnjë informacion tjetër, për rrjedhojë është në pamundësi për t'i kontaktuar;*
 - d) *i referohemi periudhës së viteve '99-'00, pra rreth 4 vite përpara se të miratohej ligji nr. 9049/2003, për deklarimin e pasurisë e, përpos kësaj, nga ky fakt nuk është menduar asnjëherë se do të përfitohej ndonjë shpërblim, prandaj nuk ka ekzistuar as nevoja faktike e as ajo ligjore për të dokumentuar një marrëdhënie të tillë.*
38. Po ashtu, subjekti ka pretenduar reduktimin e shpenzimeve të jetesës për bashkëshortin në masën 80%, pasi ai ka pasur të siguruar ushqimin dhe veshjen, për shkak të detyrës dhe funksionit të tij.

Vlerësimi i trupit gjykues

39. Pas analizimit të prapësimeve të subjektit lidhur me mosdeklarimin e pasurisë dhe burimit të krijimit të saj në DIPP-në e vitit 2004, për shkak të mungesës së eksperiencës në mënyrën se si duhet të deklaroheshin pasuritë, trupi gjykues çmon se kjo pasaktësi e vetërregulluar më pas, nuk mund të pasjellë penalizim për subjektin e rivlerësimit, për më

¹⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 11.6.2024, lëshuar nga DRT Tiranë.

tepër që nuk shoqërohet me ndonjë pamjaftueshmëri domethënëse të burimit të krijimit, sikurse është analizuar në vijim.

40. Lidhur me konstatimin e Komisionit se çmimi i apartamentit ka rezultuar më i ulët se ai i përlllogaritur sipas çmimit të referencës të Entit Kombëtar të Banesave, trupi gjykues çmon se ky fakt nuk mund të pasjellë ndonjë penalitet në raport me pozitën e subjektit, pasi: (i) në lidhjen e kontratës ka mbizotëruar vullneti i lirë dhe i përbashkët i palëve, i shprehur në kontratë dhe i konfirmuar edhe më pas, duke mos iu referuar ndonjë akti ligjor/nënligjor në raport me këtë shitblerje; (ii) nga pala shitëse asnjëherë nuk ka pasur ndonjë kundërshtim qoftë edhe të mëpasshëm për kontratën e lidhur, as në rrugë administrative dhe as gjyqësisht; (iii) vlera e kontratës është konfirmuar nga shitësi edhe pas rreth 20 vitesh (në konsistencë të plotë), duke rishprehur vullnetin e treguar në marrëdhënien kontraktore, e pohuar gjithashtu gjendjen emergjente në familjen e tij asokohe, që ka shkaktuar nevojën e shitjes së apartamentit *de quo* sa më parë; (iv) subjekti nuk ka rezultuar të gjendej në kushtet e konfliktit të interesit, pasi nuk ka shqyrtuar asnjë proces gjyqësor gjatë ushtrimit të detyrës me palë shitësin, rrethanë kjo e konfirmuar edhe nga hetimi i plotë i kryer nga Komisioni lidhur me këtë aspekt.
41. Për sa i përket konstatimit të subjektit për një pamundësi financiare të tij, në masën – 517.039 lekë, lidhur me të cilën ka pretenduar se ka rezultuar si pasojë e mospërfshirjes së të ardhurave në masën 14.600 USD, trupi gjykues çmon se vlerësimi i konsiderimit të tyre në analizën financiare fokusohet në drejtim të provueshmërisë së krijimit të këtyre të ardhurave dhe plotësimit të kriterëve të parashikuara prej nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me ligjshmërinë e tyre.
42. Në vlerësimin e kësaj situatë faktike, nën dritën e kuadrit ligjor të kohës shihet e vlefshme të përmenden disa konstatime rreth kohës së përfitimit të të ardhurave në fjalë, duke i konsideruar në tërësinë e rrethanave të faktit që lidhen me këtë moment, si më poshtë:
 - a) Subjekti i ka deklaruar të ardhurat në vlerën 14.640 USD, në DIPP-në e vitit 2004, si dhe në deklaratën *Vetting*, si të ardhura nga qiraja, të paformalizuara me kontratë qiraje dhe pa tatim të paguar.
 - b) Në mbështetje të deklaramit të saj, subjekti ka paraqitur një deklaratë “Konfirmim” të shtetasit M. Ll. , njehsuar me origjinalin me aktin noterial nr. ***, datë 12.5.2020. Në aktin “Konfirmim”, ku citohet ndër të tjera se shuma në fjalë i është dorëzuar z. S. S. me vonesë, rreth viteve 2002 – 2003, si dhe një vërtetim të datës 13.4.2003, lëshuar nga shtetasi B. M., njehsuar me origjinalin me aktin noterial nr. ***, datë 12.5.2020, që referon pikërisht përfitimin e këtyre të ardhurave nga familja e subjektit, për shkak të strehimit të disa gazetarëve të huaj në banesën e tyre.
 - c) Nga korrespondenca e Komisionit me Intesa Sanpaolo Bank ka rezultuar se në datën 22.12.2003 bashkëshorti i subjektit ka çelur një llogari në këtë bankë, duke depozituar shumën 12.177 USD – e cila pretendohet se rridhte pikërisht nga këto të ardhura.
 - d) Nga ana tjetër, pas njoftimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka paguar tatimin në burim për këto të ardhura, pagesë e cila është konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2024, të lëshuar nga DRT Tiranë.
43. Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerëson të evidentojë sa vijon:

Së pari, të ardhurat e realizuara nga qiradhënia e banesës për periudhën 2000 – 2002 nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë. Referuar vërtetimit të mësipërm, këto të ardhura duhet të ishin deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2003 (e cila është dorëzuar në mars të vitit 2004, ndërkohë që subjekti i ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004, që është dorëzuar në mars të vitit 2005), pra *de facto* ato janë deklaruar me vonesë dhe jo në kohë rale; *së dyti*, deklarimi i personit, që ia ka dorëzuar bashkëshortit të subjektit të ardhurat në fjalë, është kryer gjithashtu në distancë kohore nga faktet e pretenduara dhe jo në kohën kur janë paguar/përfitur/marrë *de facto* shumat; *së treti*, pavarësisht se subjekti ka pretenduar se depozita e krijuar në Intesa Sanpaolo Bank në vitin 2003 është furnizuar me të ardhurat nga qiraja, në dokumentin e depozitimit të shumës 12.177 USD, nuk ka rezultuar përshkrimi i origjinës së kësaj shume; *së katërti*, subjekti nuk paraqiti ndonjë dokument, dhe as nga hetimi nuk rezultoi ndonjë i tillë, që të provonte lidhjen e këtyre të ardhurave, në kohën kur pretendohet se janë përfitur, dhe depozitës; dhe *së fundi*, pavarësisht mungesës së kontratës së qirasë në një formë shkresore, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë bërë ndonjë përpjekje (përgjatë 20 viteve) për plotësimin e kërkesave të ligjit, në aspektin tatimor, për ligjshmërinë e të ardhurës së realizuar prej tyre. Pagesa e tatimit për këto të ardhura nga subjekti është kryer vetëm pas njoftimit të rezultateve nga Komisioni, pra vetëm në kuadër të legjitimitimit të tyre në funksion të procesit të rivlerësimit – dhe jo në kuadër të përmbushjes së një detyrimi ligjor.

44. Për rrjedhojë, nga aktet e administruara nuk rezultoi e provuar dhe as krijohet plotësisht bindja mbi ekzistencën e marrëdhënies së qirasë në kohën, dinamikën dhe në termat apo në nivelin e përfitimeve, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit – për periudhën 2000 – 2002. Nisur nga sa më sipër, por edhe nga fakti se nuk rezultoi e paprovuar në aspektin sasior vlera e të ardhurave të pretenduara se ato janë krijuar pikërisht prej kësaj marrëdhënieje, si dhe nga mospagimi në kohë i detyrimeve tatimore lidhur me to, Komisioni vlerëson se, ndonëse në mënyrë indirekte ka pasur një sërë *indiciesh* apo provash, ato mbeten të pamjaftueshme dhe, për pasojë, kjo shumë nuk e kalon testin, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si *conditio sine qua non*, e kësaj vlera prej 14.600 USD nuk mund të konsiderohet në analizë financiare si një burim i ligjshëm – ndonëse rrethanat e lartpërmenduar mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor të këtij kriteri.
45. Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të jetesës për bashkëshortin e saj, në masën 80%, për shkak se ato mbuloreshin nga punëdhënësi i tij, Komisioni, duke konsideruar kontekstin specifik dhe bazueshmërinë e pretendimit të subjektit, ka verifikuar në Anketën e Buxhetit Familjar përqindjen e pjesës takuese që zënë veshjet dhe ushqimi në shportën e shpenzimeve jetike. Nga ky verifikim ka rezultuar se shpenzimet në fjalë, të dyja së bashku zënë rreth 50% (një mesatare e përafërt) të totalit, e për rrjedhojë ka aplikuar zbritjen e shumave përkatëse në periudhën e referuar, sipas të dhënave vjetore.
46. Për sa më sipër, pas përlllogaritjeve¹⁵ të kryera, *mutatis mutandis*, duke reduktuar shpenzimet e jetesës për bashkëshortin në masën 50%, për periudhën 1995 – 2003, ka

¹⁵ Për vitet 1995 – 1999 sipas jurisprudencës së Kolegjit, shpenzimet jetike janë në masën 30% e të të ardhurave. Përlllogaritja në këto vite për bashkëshortin e subjektin është kryer si vijon. Nga totali i të ardhurave (subjekti dhe bashkëshortja) në shumën 2.368.457 lekë janë përlllogaritur shpenzimet në masën 30%, që i korrespondojnë vlerës 710.537 lekë. Nga kjo shumë, pjesa takuese e bashkëshortit është 142.107 lekë (1/5, pasi familja përbëhet nga 5 anëtarë). Vlerës prej 142.107 lekësh i është zbritur masa 50%, meqenëse bashkëshorti i subjektit ka përfitur veshjet dhe ushqimin për shkak të

rezultuar se zëri i shpenzimeve në analizën financiare të kryer nga Komisioni ndryshon nga 2.658.491 lekë që ishte në rezultate, në shumën 2.329.035 lekë. Për rrjedhojë të këtij ndryshimi, ndryshon edhe balanca në fund të vitit 2003, duke u zbehur kështu pamundësia financiare për këtë pasuri, nga -517.039 lekë që ishte në rezultatet e hetimit, në -187.583 lekë, si në tabelën në vijim.

Tabela nr. 1 – Analiza për blerjen e apartamentit në Tiranë

Të ardhura nga paga e subjektit 1995 - 2003	3,357,332
Të ardhura nga paga e bashkëshortit 1995 - 2003	3,523,472
Shpenzime jetese 1995 - 2003 (për 5 persona)	(2,329,035)
Shpenzim për blerje automjeti	(415,800)
Investim në depozite me afat Intesa SanPaolo	(1,323,552)
Shpenzim për blerjen e apartamentit në Tiranë	(3,000,000)
Rezultati në fund të vitit 2003	(187,583)

2. Lidhur me një apartament me sipërfaqe 73,5 m², në Kukës, dhe me një depozitë bankare të vitit 2004

47. Në DIPP-në e vitit 2003 subjekti ka deklaruar si vendbanim një apartament të ndodhur në Lagjen Nr. ***, shk. ***, ap. ***, nr. ***, z. k. ***, në Kukës. Po në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar edhe pagesën e kryer për shlyerje të kredisë në shumën 2.000.000 lekë, në Bankën e Kursimeve, të disbursuar në datën 15.3.2004.
48. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se kredia e mësipërme është akorduar nga Ministria e Mbrojtjes, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 23.1.2003, “Për trajtimin me strehim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”, pasi bashkëshorti i subjektit ka pasur statusin “ushtarak i lartë”.
49. Komisioni ka administruar nga ASHK-ja¹⁶ dokumentacionin që i përket pasurisë së sipërcituar dhe ka konstatuar se këtë pasuri z. S. S. e ka blerë nga shtetasi E. K. (vëllai i subjektit), me anë të kontratës së datës 8.3.2004¹⁷, në vlerën 2.000.000 lekë. Bashkëlidhur kësaj kontrate ka rezultuar një mandat me nr. ***, i datës 10.2.2010, për pagesën e tatimit për pasurinë në fjalë në vlerën 120.550 lekë nga z. K., ku citohet “Pagesë sipas kontratës së datës 8.3.2004”. Po ashtu, ka rezultuar edhe certifikata e pronësisë, si dhe kartela e pasurisë, në të cilën evidentohet historiku i pronarëve të saj¹⁸.
50. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar shitjen e apartamentit në analizë në vlerën 3.227.850 lekë me shënimin: “Zbritur tatimi në vlerën 205.550 lekë”. Shitja e pasurisë në fjalë është finalizuar me kontratën nr. ***, datë 23.3.2010¹⁹.
51. Në vijim, me anë të kontratës së shitjes me kusht nr. ***, datë 17.2.2010²⁰, pasuria në fjalë i është shitur shtetasit A. D. në vlerën 1.734.000 lekë. Në këtë kontratë është cituar se shuma 347.000 lekë është likuiduar *cash*, ndërsa shuma 1.386.000 lekë do të likuidohej nëpërmjet BKT-së brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, moment kur do të bëhej edhe kalimi i

profesionit të tij. Për këtë periudhë shpenzimet e jetesës për bashkëshortin janë në shumën 71.054 lekë, ndërsa për secilin anëtar të familjes është në masën 142.107 lekë. Për vitet 2000 – 2003 shpenzimet e jetesës për një person janë në masën 93.864 lekë/vit. Kjo vlerë është e njëjtë për të gjithë periudhën. Totali për 4 vite është 357.456 lekë. Pas reduktimit të shpenzimeve të jetesës për bashkëshortin në masën 50%, shpenzimet e tij jetike do të jenë në masën 46.932 lekë/vit ose 187.728 lekë për 4 vite.

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.6.2023.

¹⁷ Nr. koleksioni dhe repertori i pidentifikueshëm, ndonëse ekzistojnë.

¹⁸ Z. K. e ka përfutur këtë apartament në vitin 1998.

¹⁹ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 3.5.2024.

²⁰ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 3.5.2024.

pronësisë (pasi blerësi të përfitonte kredinë për likuidimin e kësaj vlere). Subjekti ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 2 se ky transaksion nuk ka qenë objekt i pagesës së tatimit, pasi nuk ka pasur fitim.

52. Gjithashtu, me anë të një tjetër kontrate të së njëjtës datë, por me nr. ***²¹, subjekti dhe bashkëshorti i kanë shitur z. D. pajisjet dhe orenditë e apartamentit në fjalë, në vlerën 1.700.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se në këtë çmim janë përfshirë shpenzimet e kryera prej saj dhe bashkëshortit për: blerje pajisjesh në vlerën rreth 150.000 lekë; riparim i tarracës në vlerën 280.000 lekë, në vitin 2008; si dhe vendosje e grilave në vlerën 260.000 lekë, në janar të vitit 2010.
53. Lidhur me marrëdhënien me shtetasit A. dhe Dh. D., subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur njohje dhe as nuk ka shqyrtuar ndonjë çështje ku këta shtetas të ishin palë.
54. Po ashtu, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës²² është konfirmuar se në emër të shtetasve të mësipërm nuk kanë rezultuar çështje penale apo civile të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit.

2.1 Analiza e burimeve të krijimit të shumës 2.000.000 lekë, e depozituar në bankë, si dhe për blerjen e apartamentit me sip. 73,5 m², në Kukës²³

55. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se depozita bankare e deklaruar prej tij në DIPP-në e vitit 2003, me burim nga të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit ka qenë një lapsus nga ana e saj, pasi në fakt ajo përbëhej nga: (i) kredia e përfituar nga bashkëshorti për strehim, në mars 2004, e disbursuar dhe tërhequr në datën 15.3.2004 dhe në datën 16.3.2004 është ridepozituar në bankë; (ii) shuma 450.000 lekë me burim nga kursimet nga të ardhurat nga familja përgjatë atij viti.
56. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se apartamenti i blerë me kredinë në fjalë ishte në pronësi të vëllait, i cili e kishte blerë në vitin 1998²⁴ dhe dëshironte ta shiste për shkak se do të emërohej me detyrë në Tiranë²⁵. Duke qenë se vëllait nuk i nevojitej me urgjencë pagesa, shuma prej 2.000.000 lekësh u ridepozitua në bankë, për t'u tërhequr në maj të vitit 2005 dhe së bashku me interesat i është dorëzuar vëllait (*cash*). Subjekti ka parashtruar se për shkak të marrëdhënies motër e vëlla (si një marrëdhënie e posaçme familjare), veprimet e mësipërme nuk janë formalizuar me dokumente.
57. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nga Raiffeisen Bank²⁶ janë përcjellë: kontrata e kredisë e datës 15.3.2004 për akordimin e shumës 2.000.000 lekë, kontrata e hipotekimit nr. ***, datë 15.3.2004, për vendosjen si garanci të apartamentit të ndodhur në Tiranë, e blerë në datën 23.12.2003, si dhe kontrata e shitblerjes me kusht kreditimi (marrjen e kredisë) nr. ***, datë 8.12.2003²⁷.

²¹ Po aty.

²² Shkresa nr. *** prot., datë 23.3.2023.

²³ Kjo analizë bëhet e nevojshme për këto pasuri të cilat, ndonëse nuk kanë ekzistuar në posedim nga subjekti në momentin e deklaratës *Vetting* (e për pasojë as nuk janë deklaruar), ndërthuren dhe ndikojnë në analizën financiare të vitit 2004 (e ndoshta edhe të vitit 2005), sikurse përshkruhet më tej.

²⁴ Kontratë shitje e vitit 30.4.1998 pala blerëse E. K. dhe pala shitëse B. M., si dhe vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës për përfundimin e ciklit shkollor 2001 – 2004.

²⁵ Subjekti ka paraqitur një vërtetim nr. *** prot., datë 5.5.2023 lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës për përfundimin e ciklit shkollor 2001 – 2004, si dhe një certifikatë e gjendjes familjare në datën 1.1.2003 deri në datën 31.12.2003 e Njesisë Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, për të provuar se vëllai është transferuar në Tiranë.

²⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2021.

²⁷ Komisioni është vënë në dijeni nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, se arkiva e ish-noterit Bexhet Gjana (i cili ka hartuar kontratën në fjalë) administrohej nga noteri B. Gj. Pas kërkesës së Komisionit, ky i fundit me *emailin* e datës 14.5.2024, ka

58. Po ashtu, nga Raiffeisen Bank²⁸ historiku i lëvizjeve në llogarinë dyemërore të subjektit dhe bashkëshortit të saj, nga ku ka rezultuar një depozitë e krijuar më 16.3.2004, me një derdhje *cash* në shumën 2.000.000 lekë. Më tej, kjo shumë ka kaluar në depozitë 3-mujore, sikurse edhe një tjetër derdhje e datës 28.7.2004, në shumën 450.000 lekë. Këto depozita janë mbyllur më 17.5.2005 duke u tërhequr nga subjekti përkatësisht shumat 2.084.852 lekë dhe 463.060 lekë, duke paraqitur lëvizjet përkatëse bankare.
59. Gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar dy kontrata shitblerjeje për pasurinë në analizë me data të ndryshme (njëra e administruar nga banka nënshkruar më 8.12.2003 dhe tjetra e administruar nga ASHK-ja, e nënshkruar më 8.3.2004). Nisur nga ky konstatim, Komisioni e ka ftuar subjektin nëpërmjet pyetësorit nr. 2 të paraqiste shpjegime lidhur me ekzistencën e dy kontratave për të njëjtën pasuri. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka shpjeguar se bëhej fjalë për një lapsus të noterit – dhe se ky veprim nuk ka sjellë pasoja juridike dhe as nuk ka ndryshuar çmimin e blerjes apo termat e kontratës së nënshkruar prej tyre. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se në momentin e plotësimit dhe të dorëzimit të DIPP-së së vitit 2003 (në mars të vitit 2004), familja e saj kishte filluar të jetonte në këtë apartament, për këtë arsye e ka deklaruar këtë pasuri si vendbanim.
60. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur: vërtetimin nga Bashkia Kukës të datës 22.5.2015, sipas të cilit, prej vitit 1994 deri në fund të vitit 2003 familja e z. S. ka banuar në Shtëpinë e Ushtarakëve Kukës; dy deklarata noteriale; urdhrin nr. ***, datë 4.7.2003, për miratimin e kredisë në shumën 2.000.000 lekë. Pas miratimit të kredisë dhe nevojës për paraqitjen e kontratës me kusht në bankë, subjekti dhe bashkëshorti kanë nënshkruar pranë noterit kontratën përkatëse dhe një kopje të saj e kanë dorëzuar pranë Bankës së Kursimeve, ndërkohë që kopjen tjetër e dispononte noteri, cili gabimisht ka referuar një datë të ndryshme, ndërkohë që nuk ka asnjë ndryshim në numrat e repertorit dhe koleksionit të kontratës.
61. Sa më sipër është konfirmuar edhe nga dokumentacioni i përfitimit të kredisë²⁹, i përcjellë nga Ministria e Mbrojtjes³⁰. Nga shqyrtimi i tij, ndër të tjera rezultoi se në datën 4.3.2003, z. S. ka paraqitur kërkesë për aprovim kredie dhe pas miratimit në datën 15.3.2004 është disbursuar kredia dhe në po këtë datë është tërhequr shuma nga bashkëshorti i subjektit. Po ashtu, nga dokumentacioni i mësipërm rezultoi se Shtëpia e Ushtarakëve Kukës në datën 30.4.2008 ka kaluar në pronësi të Bashkisë Kukës (nga Ministria e Mbrojtjes).
62. Ujësjiellës Kanalizime Kukës sh.a.³¹ ka bërë me dije se për periudhën 1998 – 2010 nuk disponohen kontrata për abonentët. Po në këtë shkresë është cituar se kontrata e furnizimit me ujë të pijshëm për pasurinë e sipërpërmendur, nga prilli 2010 e në vijim rezulton në emër të shtetasit A. D.
63. FSHU-ja³² ka bërë me dije se nuk disponon të dhëna përpara vitit 2007. Ky institucion ka konfirmuar kontratën e furnizimit nr. **** në qytetin e Kukësit, me gjeneralitetet S. S. , e

bërë me dije se nuk e dispononte arkivin e tij. Nisur nga fakti se Komisioni e ka administruar këtë kontratë përmes disa burimeve, konkretisht: ILDKPKI, banka, ASHK, si dhe nga subjekti i rivlerësimit, si dhe duke qenë se mes tyre nuk u konstatuan mospërputhje, nuk u vlerësua e nevojshme të procedohej me ripërsëritjen e kërkesës.

²⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2023.

²⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 27.3.2023.

³⁰ Kërkesë të bashkëshortit për strehim datë 4.3.2003, ku identifikohet se në vitet 1999 – 2003 familja banonte me qira, vërtetim nga hipoteka se nuk ka pasuri të paluajtshme, si dhe dokumentin për propozimin për dhënie kredie në masën 2 milionë lekë.

³¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2024.

³² Shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.3.2023, si dhe shkresa nr. *** prot., datë 13.5.2024.

hapur në datën 14.1.2011, e cila i korresponдон pasurisë së blerë nga subjekti në Kukës, në vitin 2010.

64. Komisioni ka përllogaritur mundësinë financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit për të likuiduar çmimin e blerjes së apartamentit të ndodhur në qytetin e Kukësit, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 8.3.2004 – nëpërmjet së cilës është kryer edhe regjistrimi i kësaj pasurie në ASHK – pas marrjes së kredisë bankare të sipërpërshkruar – dhe ka konstatuar se deri në datën 16.3.2004 (sipas kontratës), për blerjen e apartamentit në Kukës dhe njëkohësisht për krijimin e depozitës prej 2.000.000 lekësh në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej –1.789.440 lekësh.
65. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova e shpjegime të tjera/bindëse për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit lidhur me sa vijon:
- *Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003/2004 blerjen e apartamentit në Kukës në vlerën 2.000.000 lekë, por në këto vite ka deklaruar adresën e kësaj pasurie si vendbanim, si dhe kredisë e marrë për këtë qëllim dhe më pas ka deklaruar shitjen e kësaj pasurie në DIPP-në e vitit 2010.*
 - *Duket se depozita në Bankën e Kursimeve, e tërhequr prej subjektit në maj të vitit 2005, nuk mund të jetë përdorur për blerjen e apartamentit në mars të vitit 2004 (sipas kontratës).*
 - *Duket se për blerjen e apartamentit në Kukës dhe për krijimin e depozitës në datën 16.3.2004 në Bankën e Kursimeve, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej – 1.789.440 lekësh.*
 - *Duket se nuk ka logjikë ekonomike në transaksionet e kryera nga subjekti, duke shitur apartamentin ekzistues në Kukës, në një çmim më të ulët se çmimi i referencës dhe se çmimi i blerjes së këtij apartamenti nga vetë subjekti 7 vite më herët, ndërkohë që janë shitur mobiliet dhe orenditë shtëpiake në një çmim më të lartë se vlera e tyre (e shpenzuar nga vetë subjekti) – çka ngre dyshime se këto veprime janë bërë me qëllim shmangien nga detyrimet tatimore për një pjesë të të ardhurave që do të realizoheshin nga shitja e apartamentit, me çmimin total prej 3.434.000 lekësh (duke përfshirë edhe shitjen e mobilieve).*
 - *Duket se të ardhurat në masën 1.010.000 lekë (fitimi i realizuar si pasojë e diferencës pozitive midis çmimit të shitjes së mobilieve, sipas subjektit, dhe çmimit të blerjes së tyre) nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm financiar, për sa kohë, përpos mungesës së logjikës ekonomike, për këtë vlerë/diferencë (duket se) nuk janë paguar detyrimet tatimore përkatëse.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

66. Subjekti ka parashtruar se deklarimi i apartamentit si adresë e banimit të familjes, shoqëruar me kontratën e shitblerjes të bërë me akt noterial (publik), si edhe me praktikën bankare për marrjen e kredisë për strehim, qenë të mjaftueshme për t'u vetëkuptuar marrja në pronësi, e njëkohësisht krijimi i kësaj pasurie. Deklarimi si adresë banimi e familjes në mars të vitit

2004 (kur është dorëzuar edhe deklarata e parë e pasurisë) ka prezumuar pronësinë mbi këtë apartament, për këtë arsye edhe konsistenca e kësaj adrese në vitet në vijim ka pasur të njëjtën qasje dhe mënyrë të kuptuari mbi këtë pasuri.

67. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se si burim për blerjen e këtij apartamenti ka shërbyer kredia në shumën 2.000.000 lekë, e marrë nga Banka e Kursimeve (aktualisht RFZ Bank), në mars të vitit 2004, e cila është disbursuar në datën 16.3.2004³³ në llogarinë e bashkëshortit S. S. . Pavarësisht se veprimi i fillimit të depozitës përshkruhet si *derdhje cash*, në mbështetje edhe të kronologjisë së akteve shkresore të rezultuara pas disbursimit të kredisë, del e qartë se tërheqja³⁴ dhe depozitimi virtual janë bërë në të njëjtën kohë. Shuma e disbursuar ka kaluar në një llogari depozite me afat 3-mujor, të çelur po në të njëjtën datë (16.3.2004) për t'u investuar dhe riinvestuar edhe në vijim deri në datën 17.5.2005, me konsensusin e babait të subjektit, të cilit nuk i nevojiteshin lekët në atë kohë.
68. Subjekti është shprehur se është në pamundësi objektive sipas nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016³⁵, për të provuar këtë historik të përshkruar më sipër, pasi babai i saj i ndjerë ka ndërruar jetë.
69. Gjithashtu, subjekti ka kërkuar rishikimin e analizës financiare për periudhën 1.1.2004 – 16.3.2004, duke hequr krijimin e shumës së depozitës 2.000.000 lekë, si depozitë e re, si dhe reduktimin e shpenzimeve të jetesës së bashkëshortit. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2021, nga Raiffeisen Bank³⁶, ku citohet: “*Nga nxjerrja e llogarisë nuk ka të dhëna në lidhje me datën e tërheqjes së shumës së depozitës. Në sistemin e Raiffeisen Bank sh.a., shuma e mbartur për klientin S. S. në datën 1.10.2004, kur ka filluar sistemi i Raiffeisen Bank është 9.236 lekë, ndërsa për Vjollca Spahiun nuk është mbartur asnjë shumë, pasi veprimet në llogari kanë filluar me kreditimin e pagesës*”.

Vlerësimi i trupit gjykues

70. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe prapësimeve të paraqitura nga subjekti lidhur me mosdeklarimin e apartamentit nga ana e subjektit në DIPP-në e vitit 2004, trupi gjykues çmon se subjekti duhet të kishte deklaruar apartamentin në analizë edhe si pasuri e paluajtshme, përpos deklarimit që ka kryer si adresë banimi. Megjithatë, kjo pasaktësi nuk përbën shkak të mjaftueshëm për penalizimin e saj, për sa kohë e ka deklaruar atë si vendbanim (pra, pa qëllim fshehje) dhe gjithashtu nuk janë evidentuar pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme, të përdorura për krijimin e saj – sikurse do të trajtohet më tej në këtë vendim.
71. Lidhur me pretendimin e subjektit për kryerjen e pagesës për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2005 (dhe jo në vitin 2004 – siç e kishte përllogaritur Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, të njoftura), pasi si burim për të cilin ka shërbyer kredia bankare, vlerë e cila fillimisht ishte futur në një depozitë bankare që ishte tërhequr më pas, në maj 2005, pikërisht për likuidimin e çmimit të apartamentit *de quo*, Komisioni ka konstatuar sa vijon:

³³ Pjesë e dokumentacionit të administruar nga Raiffeisen Bank.

³⁴ Nga lëvizja e llogarisë së bankës së kursimeve, nuk evidentohet asnjë veprim tërheqje por vetëm ai i depozitimit.

³⁵ Neni 32, pika 2 e Ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme...”.

³⁶ Pyetësori nr. 2, përgjigja e pyetjes nr. 9.

- a) Subjekti dhe bashkëshorti kanë nënshkruar në vitin 2003 një kontratë shitblerjeje apartamenti me kusht (pikërisht, miratimin e kredisë për pagesën e tij).
- b) Në mars të vitit 2004, bashkëshortit të subjektit i është miratuar një kredi me qëllim strehimi, në shumën 2.000.000 lekë, e cila është disbursuar në datë 16.3.2004 dhe në po këtë datë shuma në fjalë është kaluar në një depozitë me afat 3-mujor (i përsëritur disa herë), deri sa në datën 17.5.2005, kur është tërhequr.
- c) Duke pasur në konsideratë se *de jure* subjekti e ka blerë këtë pasuri nga vëllai i saj, ndërkohë që sipas subjektit investuesi fillestar (blerësi) i këtij apartamenti dhe pronar *de facto* ka qenë babai i tyre, i cili kishte disponuar të ardhura për krijimin e kësaj pasurie³⁷ (për sa kohë vëllai ishte ende student) dhe, në kushtet e një marrëdhënieje të posaçme familjare (babë e bijë dhe motër-vëlla), vlerësohet i mundshëm shpjegimi i subjektit se për likuidimin e çmimit nuk i është qëndruar strikt përcaktimeve sipas kontratës së shitjes, por shuma prej 2.000.000 lekësh i është dorëzuar babait, në një moment që i nevojiteshin, në maj të vitit 2005.
- d) Nga analiza e kryer nga Komisioni është konstatuar se në vitin 2004, subjekti rezulton me një pamundësi të përafërt me vlerën e çmimit të apartamentit, ndërsa në vitin 2005, me një tepriçë sërish të përafërt me vlerën e kësaj pasurie.
- e) Gjatë vitit 2005 nuk rezulton i kryer asnjë shpenzim i pambuluar, pushime apo aktivitete të tjera investimi, që të ngrinin dyshime për destinimin apo përdorimin e vlerës së tërhequr nga depozita në maj 2005, në një drejtim tjetër.
- f) Kontrata e shitblerjes me kusht datë 8.3.2004, veç të tjerash parashikon se: “*Pagesa e vlerës së apartamentit do të bëhet nga blerësi, pas lidhjes së kontratës, pas miratimit të kredisë*”. Pra - ndryshe nga sa ishte përshkruar në rezultate – në këtë kontratë nuk citohet ndonjë pagesë e kryer paraprakisht, por i referohet shumës së disbursuar nga kredia, si burim që do të përdorej për këtë blerje.
72. Në këto kushte, bazuar në tërësinë e akteve shkresore të kohës dhe në dokumentet bankare, përmbajtja e të cilave rezultoi në harmoni me pretendimet e subjektit, mes tyre dhe provave të tjera rrethore në gamën e marrëdhënieve të posaçme/familjare, trupi gjykues i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit, sipas të cilave, depozita që është krijuar nga shuma e kredisë së disbursuar, pasi ka qenë *pro tempore* në depozitën bankare (si më sipër) deri në datën 17.5.2005, kur është tërhequr, është përdorur për pagesën e kësaj pasurie, pikërisht në përputhje me parashikimet kontraktore dhe dakordësimet midis familjarëve.
73. Për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me pamundësinë objektive për të konfirmuar veprimet, dakordësimet apo transaksionet e cituara pasi babai i subjektit ka ndërruar jetë, Komisioni çmon se nuk gjendemi në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, pasi pavarësisht pamundësisë për të paraqitur një deklaratë të babait, kjo nuk do të ishte me vlerë provuese përcaktuese, si për shkak të elementit kohor (duke u prodhuar përgjatë hetimit administrativ), ashtu edhe për prezencën e fakteve të tjera rrethore dhe të kohës që Komisioni mban në konsideratë në vlerësimin e këtij pretendimi, të cilët e bëjnë jo përcaktues apo të rëndësishëm individin të cilit i është dhënë shuma në fjalë (edhe për shkak të prezencës së marrëdhënies së posaçme), krahasimisht me momentin e pagesës.

³⁷ Referuar deklarimeve të subjektit në prapësime, në vitin 1998, kur është blerë pasuria vëllai i saj ka qenë rreth 20 vjeç (student) dhe nuk dispononte të ardhura.

74. Në përfundim, nisur nga sa më sipër, *mutatis mutandis*, Komisioni, në raport me këtë pasuri ka kryer ndryshimet përkatëse në analizën financiare, konkretisht: (i) referuar vlerësimin të mësipërm dhe përcaktimit të kontratës së shitblerjes me kusht (të datës 8.3.2004, ku citohet se “Pagesa e vlerës së apartamentit do të bëhet nga blerësi, pas lidhjes së kontratës, pas miratimit të kredisë”), çka përputhet më pas edhe me ecurinë e disbursimit të kredisë, mbylljen në depozitë afatshkurtër, e në fund likuidimin e çmimit në maj të vitit 2005, është spostuar në kohë përlllogaritja e pagesës për blerjen e apartamentit në Kukës nga viti 2004 në vitin 2005; (ii) janë reduktuar shpenzimet e jetesës për bashkëshortin e subjektit (nga 97.775 lekë në 87.998 lekë), për shkaqet e shpjeguara më sipër. Për rrjedhojë, nga analiza financiare e kryer në datën e krijimit të pasurisë në fjalë, nga një balancë negative (e konstatuar në rezultatet e hetimit në shumën 1.789.440 lekë) rezulton pozitive në masën 220.337 lekë, siç paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 2 – Analiza për blerjen e apartamentit në Kukës

Te ardhura nga paga e subjektit 1.1.2004 - 16.3.2004	134,948
Te ardhura nga paga e bashkeshortit 1.1.2004 - 16.3.2004	173,387
Shpenzime jetese 1.1.2004 - 16.3.2004 (per 5 persona)	(87,998)
Kredi nga Banka e Kursineve	2,000,000
Shpenzin per blerje apartamenti ne Kukes	(2,000,000)
Rezultati	220,337

3. Njësi shërbimi me sipërfaqe 53 m² i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë

75. Në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka deklaruar pasurinë dyqan me sip. 53 m² (asokohe ende e pahipotekuar), në vlerën 63.600 euro, të përfutur me anë të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 18.3.2005, të nënshkruar me shoqërinë “****” sh.p.k. Si burim për krijimin e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar kredinë në shumën 40.000 euro, në BKT, 23.600 euro nga kursimet familjare dhe kreditë konsumatore në Raiffeisen Bank. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur deklaratës *Vetting* mandatarkëtimet si vijon: a) nr. ***, datë 30.6.2005, për arkëtimin e shumës 40.000 euro nga z. S. S. ; b) nr. ***, datë 7.6.2010 për arkëtimin e shumës 23.600 euro.
76. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite është konstatuar se kjo pasuri nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit 2005. Megjithatë, ka rezultuar një faqe e deklaratës periodike (seksioni i deklarimit të interesave privatë), e dërguar nëpërmjet fax-it pranë ILDKPKI-së në datën 18.11.2013, në të cilën përshkruhej edhe prenotimi i pasurisë dyqan me sip. 53 m², i ndodhur në rrugën “****” (paguar kësti i parë me të ardhurat nga kredia).
77. Nga shqyrtimi i kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., datë 18.3.2005, është evidentuar se çmimi i pasurisë në vlerën 63.600 euro (1.200 euro/m²) do të likuidohej në këtë mënyrë: (i) kësti i parë prej 20.000 euro ishte paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës; (ii) kësti i dytë prej 30.000 euro ishte parashikuar të paguhej pas 5 muajve; (iii) kësti i tretë prej 10.000 euro do të paguhej me mbarimin e objektit dhe dhënien e certifikatës së pronësisë.
78. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar likuidimin e detyrimit të mbetur prej 23.600 euro, në favor të shoqërisë shitëse “****” sh.p.k., sipas mandatarkëtimin datë 7.6.2010, pa deklaruar burimin e të ardhurave të përdorur për këtë likuidim.

79. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga ASHK Tirana Jug³⁸ ka rezultuar se pasuria në analizë është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në datën 1.10.2020³⁹, në vlerën 63.600 euro, pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 19.9.2020, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k⁴⁰. Po ashtu, ky institucion ka përcjellë edhe një kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., datë 18.3.2005⁴¹, me objekt ndërtimin e një dyqani me sipërfaqe 53 m² në Rr “****” Tiranë. Sipas kontratës në fjalë, çmimi i përcaktuar ishte 1.200 euro/m².
80. Nga dokumentacioni i administruar nga BKT-ja është konstatuar se në këtë bankë është depozituar një tjetër kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 19.5.2005, e nënshkruar mes të njëjtëve palë, për të njëjtin objekt, por me pagesë 2.500 euro/m², ku kësti i parë 62.000 euro është paguar, ndërsa pjesa tjetër do të paguhet me mbarimin e objektit⁴².
81. Lidhur me konstatimin e mësipërm, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se kontrata e datës 19.5.2005 është nënshkruar vetëm për efekt të përfitimit të kredisë nga banka, pasi ajo nuk financonte më shumë se 70% të vlerës së njësive që do të blihesh.
82. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se shoqëria “****” sh.p.k. ka ndryshuar emrin në “****” sh.p.k., si dhe ka paraqitur një përgjigje të kësaj të fundit⁴³, ku ndër të tjera citohet se prenotimi dhe përfitimi i njësive është bërë për një vlerë prej 63.600 euro. Likuidimi i çmimit është bërë më dy këste, nga ku fillimisht është paguar 40.000 euro, i arkëtuar *cash* në datën 13.7.2005, për të cilin ishte lëshuar më parë mandatarkëtimi nr. ***, datë 30.6.2005 dhe vlera 23.600 euro është paguar në datën 9.6.2010, për të cilin është lëshuar edhe mandatarkëtimi nr. ***, datë 9.6.2010. Ndërsa, lidhur me ekzistencën e kontratës tjetër me datë nënshkrimi 19.5.2005, shoqëria është shprehur se nuk është administruar një e tillë prej tyre.
83. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit⁴⁴, shoqëria e mësipërme me shkresën datë 13.3.2023 ka paraqitur 3 kontrata sipërmarrjeje⁴⁵ të nënshkruara gjatë vitit 2005, për shitjen në të njëjtin objekt të dy njësive, përkatësisht me çmimin 1.200 euro/m² dhe shitjen e një apartamenti me çmimin 700 euro/m².
84. Me qëllim qartësimin mbi ekzistencën e dy kontratave të sipërmarrjes, Komisioni administroi⁴⁶ dokumentacionin që dispononte noterja M. Sh. lidhur me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 19.5.2005, të nënshkruar mes z. S. S. dhe shoqërisë “****” sh.p.k. Noterja në përgjigjen e datës 6.3.2023 ka përcjellë disa kontrata⁴⁷ të nënshkruara nga z. S. S. , si dhe ka bërë me dije se nuk dispononte aktin e sipërcituar.
85. Nga një analizë krahasimore që ka kryer Komisioni mes çmimit të dakordësuar të shitblerjes dhe të dhënave të tregut të lirë gjatë periudhës së blerjes së pasurisë në fjalë,

³⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023.

³⁹ Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegonte arsyen e regjistrimit të kësaj pasurie vetëm në vitin 2020. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti shpjegoi se si pasojë e procedurave të ndjekura nga ndërtuesi, është vonuar regjistrimi i të gjithë pallatit.

⁴⁰ Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se pasuria në analizë ka kaluar në pronësi të fëmijëve të subjektit, E. e S. S. me anë të kontratës së dhurimit nr. ***, datë 6.12.2020.

⁴¹ Administruar nga Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2023.

⁴² Në këtë kontratë nuk është përmendur fakti që ka ekzistuar një kontratë e mëparshme apo revokimi i saj.

⁴³ Me nr. *** prot., datë 6.4.2023.

⁴⁴ Me kërkesën nr. *** prot., datë 2.3.2023.

⁴⁵ Me nr. *** prot., datë 5.2.2005; nr. *** prot., datë 17.3.2005; nr. *** prot., datë 8.1.2005.

⁴⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 2.3.2023 si dhe nr. *** prot., datë 11.4.2023.

⁴⁷ Kontratë dhurimi nr. ***, datë 14.12.2020 (dhurimi i apartamentit nga bashkëshorti tek subjekti); kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 19.9.2020 (dyqani); kontratë dhurimi nr. ***, datë 5.1.2021 (dhurim automjeti djalit); kontratë dhurimi nr. ***, datë 6.12.2020 (dhurim ½ e dyqanit).

nisur nga Udhëzimi nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave për vitin 2005”, për sipërfaqen prej 53 m² ka rezultuar një çmim mesatar shitjeje prej rreth 77.425 lekë m². Për rrjedhojë, referuar këtij çmimi, vlera e dyqanit në analizë do të rezultonte rreth 4.103.525 lekë, ndërkohë që subjekti e ka blerë në vlerën 63.600 euro.

86. Në përgjigje të pyetësorit nr. 6, subjekti ka deklaruar se në këtë njësi nuk është kryer asnjë investim në momentin që është dhënë për herë të parë me qira, përmes kontratës së qirasë nr. ***, datë 18.4.2006, në vitin 2017. Në nenin 2, pika 2 e kontratës në fjalë, citohet: “*Dyqani, në momentin e dhënë me qira, është i rregullt sipas projektit dhe i papajisur*”. Përshtatja e ambientit *njësi* për t’u përdorur si *bar-kafe* është realizuar nga qiramarrësi sipas nevojave dhe ideve të tij të biznesit. Kalimi i ambientit nga njëri qiramarrës tek tjetri bëhej sipas gjendjes në të cilin ndodhej ambienti, duke mos u investuar asnjë vlerë monetare në rregullimin, mirëmbajtjen apo ndryshimin e kësaj njësie.

3.1 Analizimi i burimit të krijimit për blerjen e njësisë së shërbimit/dyqan

3.1.1 Analiza e shlyerjes së kështit të parë në shumën 40.000 euro

87. Komisioni ka administruar nga BKT-ja⁴⁸ dokumentacionin: (i) kontratë kredie bankare me nr. ***, datë 30.6.2005, me kredimarrës bashkëshortin e subjektit për shumën 40.000 euro, me objekt “Blerje shtëpie”; (ii) kontratë hipotekimi nr. ***, datë 30.6.2005, me palë hipotekuese S. dhe Vjollca Spahiu, për marrjen e kredisë, duke lënë si garanci apartamentin e ndodhur në Tiranë.
88. Kredia në fjalë është disbursuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, në datën 7.7.2005, në shumën 39.200 euro (pas mbajtjes së komisionit të disbursimit prej 2% të shumës së kredisë), i cili, pasi ka likuiduar edhe shumat përkatëse të sigurimit, ka tërhequr *cash* shumën 38.600 euro në datën 13.7.2005, ndërkohë që pagesa e kështit të parë referuar mandatit të lëshuar nga shitësi mban datën 30.6.2005. Nga shoqëria “***” sh.p.k., me nr. *** prot., datë 6.4.2023, është konfirmuar shitja e njësisë në vlerën 63.600 euro përmes likuidimit me dy këste. Fillimisht është paguar 40.000 euro, i arkëtuar *cash* në datën 13.7.2005 (po në këtë datë është tërhequr shuma nga kredia), për të cilin ishte lëshuar më parë mandatarkëtimi nr. ***, datë 30.6.2005.
89. Në DIPP-të periodike (2005, 2006 dhe 2007) subjekti ka deklaruar të ardhurat nga dhënia me qira e apartamentit të ndodhur në Tiranë, në vlerën 360.000 lekë për çdo vit (pa kontratë qiraje, por sipas deklaratës së shtetasit R. L. nr. ***, datë 10.4.2023), në shumën 1.080.000 lekë për periudhën 2005 – 2007, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në shumën 162.000 lekë në vitin 2020⁴⁹.
90. Gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar se edhe pasuria në analizë (dyqani) është dhënë me qira në vitet 2006 – 2016. Të ardhurat e realizuara janë deklaruar në deklaratat vjetore dhe në atë *Vetting*, për periudhën 18.4.2006 – 31.12.2016, në shumën 4.279.000 lekë, për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore.
91. Bashkëlidhur dokumentacionit të përcjellë nga BKT-ja⁵⁰, ka rezultuar një kontratë qiraje e vitit 2005, me shtetasin E. K. (xhaxhai i subjektit) për të njëjtin apartament kundrejt qirasë mujore prej 60.000 lekësh. Subjekti është shprehur se kjo kontratë është bërë sipas

⁴⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 19.8.2020.

⁴⁹ Subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. ***, datë 24.3.2020, të DRT-së Tiranë.

⁵⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.8.2020.

orientimit të dhënë nga punonjës të bankës, të cilët, pasi janë njohur me vlerën e qirasë së apartamentit dhe kontratën e blerjes së pasurisë në shumën 3.000.000 lekë, nuk mund të miratonin kredinë për blerjen e njësisë/dyqanit për shkak të politikave shtrënguese në vlerën e dhënies së kredisë, krahasuar me garancinë që duhej dhënë dhe vënë në dispozicion të bankës – dhe se z. K. nuk ka jetuar asnjëherë aty. Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të tij nr. ***, datë 4.5.2023.

92. Komisioni ka vlerësuar të mos i përfshijë në analizën financiare të ardhurat e mësipërme, për sa kohë nga subjekti nuk u paraqit dokumentacion ligjor i kohës, që të provonte marrëdhënien e qirasë për të gjithë periudhën e pretenduar apo përfitimin real të të ardhurave (p.sh. me transfertat bankare apo mandatarkëtimi), por edhe për faktin që pagesa e detyrimeve tatimore nuk është kryer në periudhat përkatëse, por është kryer në vitin 2020.
93. Për sa më sipër, Komisioni ka përlllogaritur mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të likuiduar këstin e parë nëpërmjet kredisë bankare, duke e konsideruar çmimin e njësisë së shërbimit në vlerën 63.600 euro (me 1.200 euro/m²) – sipas kontratës së depozituar nga subjekti pranë ASHK-së – dhe ka konstatuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare (nga kredia), të mjaftueshme për pagesën e këstit të parë për blerjen e pasurisë njësi shërbimi, pasi ka rezultuar me balancë pozitive në masën 3.136.820 lekë.
94. Ndërsa, lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të kësaj pasurie, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës si vijon:
- *Duket se ka mospërputhje mes datës kur është lëshuar mandatpagesa e këstit të parë në shumën 40.000 euro (30.6.2005) dhe datës kur janë tërhequr fondet e kredisë të deklaruara si burim për kryerjen e kësaj pagese (7.7.2005).*
 - *Duket se përgjatë procedurave të përfitimit të kredisë në fjalë, subjekti ka nënshkruar një kontratë fiktive, me një çmim më të lartë nga çmimi i shitblerjes që rezultonte në një kontratë të mëhershme.*
 - *Duket se nga tërësia e veprimeve të kryera nga subjekti, për përfitimin e pasurisë njësi shërbimi, mbetet i paqartë çmimi real i blerjes së pasurisë në fjalë dhe, për pasojë, subjekti mund të gjendet në kushtet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

95. Subjekti ka parashtruar se mospërputhja e konstatuar mes datës së mandatit dhe depozitimit faktik të këstit lidhet me një zgjedhje të administratorit, ndërkohë që pagesa fizike e shumës konfirmohet qartësisht nga libri i arkës, i shoqërisë, pasi pagesa e shumës 40.000 euro është kryer në datën 13.7.2005, pra pas datës së disbursimit të kredisë. Subjekti ka pretenduar ndryshimin e analizës financiare si vijon:
- a) *përfshirjen e pagesës së shumës së apartamentit në Kukës prej 2.000.000 lekësh (me burim nga depozita e tërhequr nga banka e kursimeve në datën 17.5.2005, në shumën 2.547.912 lekë, e cila si burim origjine ka kredinë);*
 - b) *përfshirjen e të ardhurave nga qiraja e apartamentit në Tiranë në vlerën 30.000 lekë/muaj për periudhën 7-mujore;*
 - c) *reduktimin e shpenzimeve jetike të bashkëshortit si ushtarak i lartë.*
96. Lidhur me konstatimin e Komisionit për nënshkrimin e një kontrate fiktive, subjekti ka parashtruar se që të mund të aprovohej kredia nga banka, do duhej që: subjekti dhe bashkëshorti të kishin një kontratë sipërmarrjeje me vlerën e objektit të financimit/dyqanit

që po blihej, 100.000 euro; të kishin të ardhura më të larta se ato të ofruara prej tyre, për të kompensuar mosmbulimin e kredisë me kolateral sa ç'kërkohej nga banka ose një garantor financiar me të ardhura të larta dhe stabil; të nënshkruanin si bashkëkredimarrës dhe/ose dorëzanës. Për këtë arsye, sipas orientimit nga vetë punonjësit e bankës, nga ana e bashkëshortit të subjektit është dorëzuar një kontratë me vlerë më të madhe se ajo e paguar *de facto*. Subjekti ka sqaruar se të gjitha këto akte të kërkuara nga banka janë përdorur vetëm në kuadër të përmbushjes së politikave të saj.

Vlerësimi i trupit gjykues

97. Lidhur me mospërputhjen e konstatuar nga Komisioni mes datës së disbursimit të kredisë dhe mandatpagesës së këstit të parë për blerjen e njësisë, Komisioni ka çmuar t'i referohet dokumentacionit të paraqitur së bashku me përgjigjen e shoqërisë ndërtuese⁵¹, nga ku konfirmohet se: “Çmimi për pasurinë e paluajtshme ka qenë në një total prej 63.600 euro, e cila është likuiduar sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 30.6.2005 (arkëtuar në datën 13.7.2005, sipas Librit të Arkës) të shumës 40.000 euro dhe mandatarkëtimit nr. ***, datë 7.6.2010 (arkëtuar në datën 7.6.2010 sipas Librit të Arkës), të këstit prej 23.600 euro”. Po ashtu, referuar Librit të Arkës së subjektit ndërtues “****” sh.p.k. (aktualisht *** sh.p.k.) kanë rezultuar të pasqyruara pagesat në fjalë, konkretisht: “Në datën 13.7.2005, arkëtuar nga S. S. , sipas mandatit, shuma 40.000 euro”, si dhe “Në datën 7.6.2010 pagesë kësti nga S. S. sipas mandatpagesës së shumës 23.600 euro”.
98. Gjithashtu, lidhur me çmimin e kësaj pasurie, përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:
- Kontratat e ngjashme të administruara nga shoqëria “****” sh.p.k. kanë treguar se çmimi me të cilin subjekti dhe bashkëshorti kanë blerë këtë njësi tregtare është i njëjtë me çmimin e aplikuar nga shitësi edhe në raste të tjera⁵².
 - Çmimi me të cilin subjekti e ka blerë njësinë është 63.600 euro ose rreth 8 milionë lekë, ndërsa sipas çmimeve të referencës së EKB-së ai do të ishte rreth 4 milionë lekë. Pra, është 2 herë më i lartë se ajo e përllogaritur bazuar në çmimet e referencës, arsye kjo që e përforcon faktin se çmimi real i paguar për dyqanin është 63.600 euro, sikurse është provuar nga mandatpagesat në arkën e kompanisë ndërtuese.
 - Referuar çmimit mesatar të shitblerjes së apartamenteve në qytetin e Tiranës, sipas EKB-së⁵³, në vitin 2016 (kur rezulton edhe publikimi i fundit nga ky institucion⁵⁴) ka qenë në shumën 89.137 lekë. Duke qenë se çmimet e njësisive përllogariten mesatarisht në vlerat e 2-fishit të çmimit të banesave, atëherë vlera mesatare e tjetërsimit të tyre në vitin 2016 do të ishte rreth 1.320 euro. Pra, 11 vite pas blerjes së njësisë nga subjekti dhe bashkëshorti, vlera mesatare për njësi ka pësuar një rritje gati të papërfillshme, për diferencën në kohë ndërmjet tyre.
99. Nisur nga sa më sipër, lidhur me *quantum debeat*, trupi gjykues ka konstatuar se përkojnë vlerat dhe momentet e pagesave të deklaruara e të konfirmuara si nga subjekti ashtu edhe nga shoqëria ndërtuese, si dhe modalitetet e kryerjes së pagesave për pasurinë në fjalë, duke u paraqitur në harmoni të plotë deklaratimet dhe veprimet objektive me këtë shoqëri, dhe nga

⁵¹ Referuar shkresës “Kthim përgjigje”, nr. *** prot., datë 13.3.2023, të administruar nga shoqëria “****”.

⁵² Në bazë të tri kontratave të vendosura në dispozicion, për ato me nr. ***, datë 5.7.2005; nr. ***, datë 8.7.2005, dhe nr. ***, datë 17.3.2005, rezulton se mesatarisht çmimet e njësisive çmohen në dyfishin e vlerës së apartamenteve. Në rastin konkret njësitë janë tregtuar në vlerën 1.200 euro/m², ndërsa apartamentet në vlerën mesatare 700 euro/m².

⁵³ https://ekb.gov.al/****

⁵⁴ https://ekb.gov.al/****

përmbajtja e dokumenteve të administruara nga Komisioni. Për rrjedhojë, trupi gjykues e konsideron bindës deklarin e subjektit lidhur me datat dhe vlerat e pagesave të kryera për blerjen e kësaj pasurie, me çmim 63.600 euro.

100. Lidhur me konstatimin për nënshkrimin e një kontrate fiktive, trupi gjykues çmon të evidentojë dhe mbajë në konsideratë sa vijon:
- a) Kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 18.3.2005, me shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 19.5.2005 (me çmimin 2.500 euro/m²) janë nënshkruar vetëm nga bashkëshorti i subjektit.
 - b) Referuar kontratës së kredisë bankare nr. ***, datë 30.6.2005, për shumën 40.000 euro, me objekt “Blerje shtëpie”, ka rezultuar se kredimarrës ka qenë bashkëshorti i subjektit, ndërsa subjekti ka qenë dorëzanëse.
 - c) Veprimi nuk ka sjellë asnjë pasojë në raport me asnjë subjekt, duke përfshirë këtu edhe interesat privatë të institucionit financiar bankar, qëllimi i paraqitjes së aktit me vlerë të ndryshme/më të lartë pranë BKT-së lidhet drejtpërdrejt dhe vetëm me procesin e kreditimit para kësaj të fundit, për t’u përshtatur me politikën e saj.
101. Në këto kushte, përdorimi i aktit me shifra monetare më të larta sesa realiteti, i sugjeruar apo përgatitur nga banka dhe i nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit sipas orientimeve të bankës, nuk ka pasur si qëllim për t’u shmangur nga detyrimi për kthimin e saj, por mundësimin e marrjes. Sikurse ka rezultuar nga hetimi, kredia është përfituar jo në kushte preferenciale, por në kushtet e tregut, për qëllimin e deklaruar dhe kthyer sipas kontratës, duke u paguar e plotë përpara përfundimit të afatit të parashikuar. Në këto kushte, veprimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit nuk mund të afektojnë vetë subjektin, qoftë edhe në aspektin etik.
102. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se nuk rezultojnë *indicie* për të qenë përpara dyshimit të nenit D të Kushtetutës, në raport me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, për sa kohë që provohet marrëdhënia juridike me subjektin ndërtues; janë të dokumentuara me akte të kohës veprimet financiare; është konstatuar se çmimi i blerjes ishte shumë më i lartë se ai i referencave të EKB-së dhe është provuar mënyra dhe koha e pagesave me burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të përballuar krijimin e pasurisë, njësi me sip. 53 m².
103. Për sa i përket pretendimit të subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga qiraja e apartamentit në Tiranë, Komisioni ka konstatuar se të ardhurat e pretenduara arrijnë një vlerë totale prej 1.080.000 lekësh. Në DIPP-të periodike (2005 – 2007) është deklaruar periudha e dhënies së apartamentit me qira, vlera e përfituar, si dhe fakti se kjo marrëdhënie nuk ka qenë e formalizuar përmes një kontrate me shkrim (për shkak të afatit më pak se 1 vit). Marrëdhënia e qirasë është konfirmuar edhe përmes deklaratës së qiramarrësit, e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Po ashtu, referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 17.2.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, konfirmohet pagesa e tatimit në burim në shumën 162.000 lekë, e cila i korrespondon të ardhurave të përfituara prej 1.080.000 lekësh (1.080.000 x 15% = 162.000 lekë). Gjithashtu, sipas konfirmës bankare të lëshuar nga RZB mbi detajet e pagesës sqarohet “162.000 all, tatim burim mbi qira, banesë Tiranë Blv. “****”, nd. ***, vitet 2005 – 2007”, me përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

104. Për sa më sipër, pas vlerësimit të pretendimeve të subjektit, edhe në këtë rast *mutatis mutandis*, Komisioni ka korigjuar analizën financiare: (i) duke shtuar të ardhurat nga qiraja⁵⁵ e apartamentit në Tiranë (të cilat kanë rezultuar të deklaruara dhe për të cilat është paguar asokohe detyrimi tatimor); (ii) duke reduktuar shpenzimet e jetesës për bashkëshortin – siç është sqaruar më sipër (tek pasuria nr. 1); (iii) është zhvendosur pagesa e apartamentit në vitin 2005 – si më sipër. Për rrjedhojë të këtyre ndryshimeve, rezultati financiar, i cili në rezultate ishte në masën 3.136.820 lekë, pas ndryshimeve rezulton sërish pozitiv, por tashmë në masën 1.399.316 lekë, siç paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 3 – Analiza financiare e burimeve për pagesën e këstit të parë të dyqanit

Të ardhura nga paga e subjektit 1.1.2005 - 13.7.2005	540,291
Të ardhura nga paga e bashkëshortit 1.1.2005 - 13.7.2005	606,103
Të ardhura nga qiraja e apartamentit	210,000
Shpenzime jetese 1.1.2005 - 13.7.2005 (5 persona)	(267,045)
Shpenzime të kredisë në Bankën e Kursimeve	(66,389)
Tërhequr nga kredia në BKT	4,730,044
Paguar kësti I-rë i apartamentit 13.7.2005	(4,901,600)
Tërhequr depozita nga Banka e Kursimeve në 17.5.2005	2,547,912
Likuidimi i çmimit të apartamentit në Kukës 17.5.2005	(2,000,000)
Rezultati në datë 13.7.2005	1,399,316

3.1.2 Analiza e shlyerjes së kredisë në BKT (me burim nga huaja dhe kursimet)

105. Në seksionin e detyrimeve të DIPP-së së vitit 2007, subjekti ka deklaruar shlyerjen e kësteve të kredisë në BKT deri në datën 7.9.2007, në shumën 4.920 euro dhe shlyerjen e plotë të pjesës së mbetur prej 33.950 euro, ndërsa në seksionin e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruar marrjen e një huaje në shumën 3.000.000 lekë nga z. A. I. S.⁵⁶, për shlyerjen e kredisë në BKT, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 8.10.2007.
106. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “*Kredi në Raiffeisen Bank në datën 10.7.2008, në vlerën 1.000.000 lekë, me qëllim shlyerjen e borxhit ndaj z. A. S. (këst mujor 21.000 lekë.) Në rubrikën e të dhënave konfidenciale të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar shlyerje e pjesshme e huas sipas kredisë së sipërcituar në vlerën 1.000.000 lekë, si dhe 1.000.000 lekë shlyer nga kursimet gjatë vitit (gjithsej 2.000.000 lekë shlyer huaja)*”.
107. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se në vitin 2007 bashkëshorti i saj ka marrë hua nga miku i tij A. S. shumën 3.000.000 lekë, pa interes dhe pa afat kthimi, sipas deklaratës noteriale të sipërcituar. Sipas deklaratës në fjalë dhe shpjegimeve të subjektit në pyetësorin nr. 1, huaja (është depozituar në BKT dhe është konvertuar në euro) dhe një kredi që subjekti do të merrte në Raiffesen Bank do të përdroreshin për likuidimin e kredisë së marrë prej bashkëshortit të saj në vitin 2005 në shumën 35.100 euro.
108. Kredia (së bashku me interesat dhe komisionet për mbylljen e parakohshme) është likuiduar totalisht në datën 9.10.2007, me të ardhurat në shumën 1.100 euro të

⁵⁵ Janë shtuar të ardhurat nga dhënia me qira e apartamentit në Tiranë, më masën 360.000 lekë/vit, për vitet 2005, 2006 dhe 2007, ndërkohë që në rezultate ishin konsideruar të ardhurat në masën 420.000 lekë në vitin 2006 dhe 270.000 lekë në vitin 2007.

⁵⁶ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2023, informoi se nuk ka çështje penale/civile të shqyrtuara nga subjekti në emër të këtij shtetasi.

depozituara *cash* në datën 8.10.2007, si dhe nga një transfertë bankare në shumën 33.950 euro (konvertuar shuma 4.148.690 lekë) në datën 9.10.2007, të cilën subjekti e kishte depozituar në llogarinë e saj në BKT, në datën 8.10.2007. Veç sa më sipër, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka parashtruar se si burim për likuidimin e kredisë ka shërbyer edhe gjendja *cash*, e cila është zëvendësuar deri në fund të vitit 2007.

109. Lidhur me burimin e ligjshëm të huadhënësit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka shpjeguar se z. S. dispononte pasuri të paluajtshme, për të cilën ishte pajisur me leje ndërtimi në korrik të vitit 2006. Në vitin 2007, z. Sula kishte marrë paradhënie shumën 4.000.000 lekë nga z. Sh. për shitjen e kësaj pasurie, pasi të përfundonte procedura e legalizimit. Me anë të prokurës nr. ***⁵⁷, datë 16.4.2011, z. S. ka autorizuar z. N. Sh. për të siguruar blerjen e kësaj pasurie. Në pikën 7 të prokurës citohet se: *“Z. S. i ka dhënë të drejta të plota blerësit të pasurisë z. Sh., për ta përfaqësuar përpara të gjitha institucioneve për procedurat që do të jenë në shërbim të projektit në fjalë deri në momentin final të realizimit të kontratës së shitblerjes ...se e njeh si pronarë të këtij objekti... që nga momenti i redaktimit të kësaj prokure, por për procedurë do të jetë në dispozicion të tij për realizimin e aktit të shitblerjes ...”*.
110. Subjekti ka paraqitur deklaratën nr. ***, datë 26.7.2007⁵⁸, në të cilën z. Sh. ka deklaruar se i ka dhënë parapagim z. S. shumën e sipërcituar. Shitja e pasurisë në fjalë në shumën 15.000.000 lekë është finalizuar me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***⁵⁹, datë 6.10.2012. Detyrimet tatimore përkatëse për të ardhurat nga shitja janë paguar në momentin e shitjes përfundimtare të pasurisë.
111. Kontrata e shitblerjes e cituar më sipër ka rezultuar e raportuar nga noterja edhe pranë DPPPP-së, e cila ia ka përcjellë këtë informacion Komisionit me shkresën e datës 18.8.2021.
112. Në mbështetje të deklarimeve të tij në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 3, subjekti i rivlerësimi ka paraqitur dokumentacionin mbështetës si vijon:
- a) *Deklaratë noteriale për njohje detyrimi nr. ***, datë 26.7.2007, nënshkruar mes shtetasve A. S. dhe N. Sh., të cilët kanë deklaruar se janë në marrëveshje për blerjen e një pasurie truall dhe ndërtesë në qytetin e Kukësit dhe për këtë z. S. ka marrë një parapagim në shumën 4.000.000 lekë, ndërsa diferenca kur të kryhet shitja e pasurisë.*
- b) *Deklaratë dore e datës 25.7.2007 (bashkëngjitur deklaratës së mësipërme), e z. N. Sh., i cili ka deklaruar dhënien e shumës 4.000.000 lekë si parapagim për blerjen e pasurisë, duke shtuar se pjesa e mbetur e çmimit do të likuidohej në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe përfundimit të procedurave sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 10.7.2006.*
- c) *Prokurë e posaçme nr. ***, datë 16.4.2011, me të cilën z. S. ka emëruar si përfaqësues të tij z. N. Sh. (blerësin e ardhshëm) për të ndjekur procedurat e legalizimit, regjistrimit dhe shitjes së pasurisë në favor të tij, duke shtuar se: “...sepse në realitet unë sipas aktmarrëveshjes kam marrë vlerën e shitblerjes së kësaj pasurie (objekt) dhe ndërmjet nesh nuk ka detyrime të natyrës së çmimit të shitblerjes...”*

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Administruar nga Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2024, së bashku me kopjen e regjistrimit ku është regjistruar ky akt noterial.

⁵⁹ Administruar nga Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 3.5.2024, së bashku me kopje të regjistrimit ku evidentohen aktet noteriale.

d) Kontratë nr. ***, datë 6.10.2012, për shitjen e apartamentit në vlerën 15.712.245 lekë.

113. Nisur nga sa më sipër, duke u bazuar në faktet e konstatuara dhe nën dritën e detyrimeve që rrjedhin për institucionet e rivlerësimit për të hetuar e vlerësuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive, sipas pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 30 dhe 32 të ligjit nr. 84/2016, dhe në funksion të verifikimit të burimeve financiare të ligjshme, Komisioni analizoi rrethanat e faktit të rezultuara nga hetimi, së pari në drejtim të të provuarit të ekzistencës së marrëdhënies së huas e së dyti në funksion të mjaftueshmërisë së të ardhurave të huadhënësit për të justifikuar me burime të ligjshme dhënien e huas në fjalë.
114. Për sa i përket ekzistencës së marrëdhënies së huas, nga hetimi rezultoi se subjekti e ka formalizuar në kohë këtë marrëdhënie (sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 8.10.2007), si dhe e ka deklaruar huan në fjalë si në deklaratat periodike, po ashtu edhe në deklaratën *Vetting*.
115. Lidhur me mjaftueshmërinë e të ardhurave të huadhënësit për të justifikuar me burime të ligjshme dhënien e huas në fjalë, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*, si dhe në referim të qëndrimeve tashmë të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se analizimi i rrethanave të faktit në rastin konkret duhet të fokusohet në dy aspekte:
- a) *Së pari*, nëse provohet se personi tjetër i lidhur mundej t’i realizonte këto të ardhura (shuma 3.000.000 lekë) me burime të ligjshme. Për t’i dhënë përgjigje kësaj çështjeje, trupi gjykues çmon t’i referohet momentit kohor të pretenduar nga subjekti lidhur me burimin e huas. Në këtë këndvështrim, rezultoi i provuar burimi i ligjshëm për vlerën që është objekt huaje, në kuptim të nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës, me burim nga të ardhurat në shumën 4.000.000 lekë, të administruara si paradhënie për shitjen e një pasurie të paluajtshme nga huadhënësi.
- b) *Së dyti*, çmohet e rëndësishme të provohet që huadhënësi kishte mundësi t’i jepte z. Spahiu hua shumën 3.000.000 lekë. Lidhur me këtë çështje, gjatë hetimit Komisioni konstatoi se: (i) nga ASHK-ja⁶⁰ nuk janë konfirmuar investime në pasuri të paluajtshme nga ana e z. Sula në periudhën në analizë (kur është dhënë huaja); (ii) nga DPSHTRR-ja⁶¹ është bërë me dije se z. S. nuk ka rezultuar të ketë investuar në krijimin e ndonjë pasurie të llojit automjet; (iii) nga verifikimi i të dhënave në bankat e nivelit të dytë nuk ka rezultuar ndonjë investim në llogari apo depozita në emër të z. A. S. përgjatë periudhës së analizuar (brenda 2 muajve nga data e marrjes së shumës prej 4.000.000 lekësh nga z. S. deri në dhënien e 3.000.000 lekëve z. S.).

⁶⁰ ASHK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2023, ka bërë me dije se shtetasi A. S., përveç pasurisë së mësipërme të shitur në vitin 2012, ka pasur edhe një pasuri të llojit apartament të përfitur nga privatizimi, pasuri e cila është dhuruar tek të tretë, në vitin 2017. ASHK Kukës me shkresat nr. *** prot., datë 22.6.2023 dhe nr. *** prot., datë 22.6.2023, ka vënë në dispozicion të njëjtin dokumentacion. Gjithashtu, nga ASHK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 22.6.2023, është përcjellë dokumentacioni sipas së cilit ka rezultuar se me anë të kontratës nr. ***, datë 16.12.2016, z. S. ka blerë nga EKB-ja një apartament në vlerën 1.178.432 lekë.

⁶¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2021.

116. Për sa më sipër rezultoi e provuar se huadhënësi ka disponuar të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në vlerën 3.000.000 lekë subjektit të rivlerësimit, me burim nga të ardhurat nga shitja e pasurisë së tij, të marra paradhënie sipas deklaratës së datës 26.7.2007.
117. Komisioni ka analizuar disponibilitetin financiar të subjektit dhe bashkëshortit të saj për likuidimin e kredisë (me burim nga huaja dhe gjendja *cash*), nga ku ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë.
118. Duke qenë se përgjatë hetimit subjekti ka pretenduar se brenda vitit 2007 ka zëvendësuar gjendjen *cash* të përdorur (shuma 1.000.000 lekë, referuar deklaramit në DIPP-në e vitit 2007) për likuidimin e kredisë, Komisioni ka analizuar disponibilitetin e saj për rikrijimin e gjendjes *cash* në këtë vit. Nga analiza e kryer subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme në masën 631.508 lekë, për likuidimin e kredisë, si dhe për rikrijimin e gjendjes *cash* lidhur me të cilën Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

119. Subjekti ka pretenduar përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga qiraja e apartamentit për periudhën 1.1.2007 – 9.10.2007, si dhe reduktimin e shpenzimeve të jetesës së bashkëshortit, çka, sipas saj, do të ndikonte në balancën negative të konstatuar nga Komisioni.

Vlerësimi i trupit gjykues

120. Pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, Komisioni ka rishikuar analizën financiare, duke përfshirë në të – sikurse më sipër – të ardhurat nga qiraja e apartamentit për periudhën 1.1.2007 – 9.10.2007, lidhur me të cilat u provua me dokumentacion ligjor pagesa e detyrimeve tatimore (në vlerën 360.000 lekë (30.000 lekë/muaj), si dhe u reduktuan shpenzimet e jetesës së bashkëshortit me 50%, për shkak të statusit të tij si ushtarak. Për rrjedhojë, rezultati në datën 9.10.2007 nga një balancë prej 334.481 lekësh të përlllogaritur nga Komisioni më herët, bëhet 685,769 lekë si në tabelën në vijim.
- 121.

Tabela nr. 4 – Analiza financiare e burimeve për shlyerjen e parakohshme të kredisë

Të ardhura nga paga e subjektit 1.1.2007 - 9.10.2007	633,481
Të ardhura nga paga e bashkëshortit 1.1.2007 - 8.10.2007	745,562
Të ardhura nga qiradhënia (e dyqanit)	210,000
Të ardhura nga qiradhënia (e apartamentit)	300,000
Shpenzime jetese janar - tetor 2007 (5 persona)	(461,582)
Hua nga shtetasi A. S.	3,000,000
Shpenzime të kredisë në Bankën e Kursimeve	(85,357)
Shpenzime të kredise në BKT janar - shtator 2007	(636,146)
Kursime cash në banesë nga viti mëparshëm	1,000,000
Ndryshim likuiditete bankare	180,536
Shpenzime të kredisë në BKT (mbyllja parakohshme)	(4,200,725)
Rezultati në datë 8.10.2007	685,769

122. Për rrjedhojë të ndryshimeve të mësipërme, do të afektohet edhe analiza për pjesën e mbetur të vitit, pasi teprica pozitive e periudhës 10-mujore të vitit, mbartet në periudhën e 2-të të tij, si dhe nga 9 tetori deri më 31.12.2007 shtohen të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Tiranë, si dhe reduktohen shpenzimet e jetesës për bashkëshortin. Për

pasojë, subjekti dhe familja e saj do të rezultojnë me një pamundësi financiare në shumën -209.964 lekë për periudhën 10.10.2007 – 31.12.2007, si në vijim.

Tabela nr. 5 – Analiza financiare e burimeve për rikrijimin e kursimeve *cash*

Të ardhura nga paga e subjektit 10.10.2007 - 31.12.2007	227,525
Të ardhura nga paga e bashkëshortit 9.10.2007 - 31.12.2007	203,666
Të ardhura nga qiradhënia (e dyqanit)	60,000
Të ardhura nga qiradhënia (e apartamentit)	60,000
Të mbartura nga periudha e mëparshme	685,769
Shpenzime jetese nentor - dhjetor 2007 (5 persona)	(92,316)
Shpenzime të kredisë në Bankën e Kursimeve	(28,486)
Ndryshimi në gjendjet e llogarive bankare	(326,121)
Rikrijuar kursimet cash në banesë	(1,000,000)
Rezultati në datë 31.12.2007	(209,964)

3.1.3. Analiza e shlyerjes së huas ndaj z. A. S.

123. Në DIPP-të e viteve 2008 dhe 2009, nga ana e subjektit të rivlerësimit është deklaruar shlyerja e huas së marrë nga z. S., si më poshtë:
- shuma 2.000.000 lekë, shlyer në vitin 2008, me burim: (i) 1.000.000 lekë kredi në Raiffeisen Bank; (ii) 1.000.000 lekë nga kursimet e krijuara nga të ardhurat e vitit;
 - shuma 1.000.000 lekë, shlyer në vitin 2009, pa deklaruar burimin e krijimit.
124. Sa më sipër është konfirmuar nga subjekti edhe në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 3, të dërguar nga Komisioni, si dhe është sqaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga pagat dhe qiratë, kredia dhe kthimi i huas është bërë gjithmonë *cash*.
125. Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.4.2023, të lëshuar nga shtetasi A. S., i cili ka deklaruar se: *“I kam dhënë z. S. një hua në shumën 3.000.000 lekë, e cila i nevojitej për mbylljen e një kredie të marrë prej tij në BKT. Shuma e dhënë hua ka qenë pa interes dhe ajo më është likuiduar e plotë përmes dy kësteve, konkretisht: në fund të vitit 2008 më është likuiduar shuma prej 2.000.000 lekësh, ndërsa në fund të vitit 2009 më është kthyer edhe huaja e mbetur prej 1.000.000 lekësh. Aktualisht nuk ka asnjë detyrim për t’u likuiduar nga S. S. kundrejt meje”*.
126. Nga dokumentacioni i përcjellë nga Raiffeisen Bank⁶² ka rezultuar se në datën 10.7.2008 subjektit i është disbursuar kredia në shumën 1.000.000 lekë, nga të cilat 900.000 lekë janë transferuar në llogari të bashkëshortit të saj, në po të njëjtën datë. Ky i fundit ka tërhequr shumën brenda muajit korrik 2008. Gjithashtu, ka rezultuar se në datën 4.10.2010, subjekti ka derdhur në Raiffeisen Bank shumën 838.550 lekë, me përshkrimin “Derdhje për mbyllje kredie”. Kjo kredi është mbyllur në datën 4.10.2010. Banka ka bërë me dije se nuk disponohet dokumentacion për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.
127. Duke qenë se likuidimet e huas janë bërë *cash*, Komisioni ka konsideruar likuidimet të bëra përkatësisht në fund të viteve 2008 dhe 2009, nisur edhe nga deklarimi i huadhënësit, siç evidentohet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 6 – Analiza financiare e burimeve për shlyerjen e huas z. S.

⁶² Me shkresën nr. 16598/1 prot., datë 4.8.2021.

Viti	2008	2009
Te ardhura te subjektit te rivleresimit	933,893	1,040,948
Te ardhura te bashkeshortit	1,471,265	1,405,667
Te ardhura nga qiradhenia	240,000	360,000
Shpenzime jetese	(614,790)	(546,480)
Shpenzime te tjera te vitit	(514,729)	(430,145)
Kredi ne Raiffeisen Bank	1,000,000	-
Shlyer huaja ndaj shtetasit A. S.	(2,000,000)	(1,000,000)
Ndryshimi ne gjendjet e llogarive bankare	42,277	(744,376)
Rezultati	557,916	85,614

128. Në përfundim të sa më sipër, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me burime të ligjshme, të mjaftueshme për likuidimin e huas ndaj z. S., me dy këste gjatë viteve 2008 dhe 2009.

3.1.4. Analiza e burimit të kështit të dytë të njësisë

129. Në DIPP-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar shlyerjen e pjesës së mbetur të çmimit të njësisë, 23.600 euro, shoqërisë “****” sh.p.k., sipas mandatit nr. ***, datë 7.6.2010, por pa deklaruar burimin e të ardhurave për likuidimin e saj, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se për kryerjen e kësaj pagese kanë shërbyer kursimet familjare dhe kreditë konsumatore pranë Raiffeisen Bank.

130. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Raiffeisen Bank ka rezultuar se me anë të kontratës nr. ***, datë 27.1.2010, bashkëshorti i subjektit ka marrë një kredi konsumatore në shumën 2.200.000 lekë, për të cilën është hipotekuar pasuria e llojit apartament, e ndodhur në Tiranë. Kjo kredi është disbursuar në llogarinë e z. S. S. , në datën 25.3.2010, dhe është tërhequr prej tij *cash*, në po të njëjtën datë. Ky transaksion ka rezultuar i raportuar edhe sipas shkresës së DPPPP-së së datës 18.8.2021.

131. Komisioni ka kryer analizën financiare për të përcaktuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të likuiduar kështin e dytë të njësisë së shërbimit në datën 7.6.2010, duke përfshirë veprimet e kryera përgjatë periudhës 1.1.2010 – 7.6.2010, mes të cilave edhe dy transaksione shitblerjeje të kryera nga subjekti i rivlerësimit, të cilat do të analizohen të detajuara në trajtimin e pasurisë nr. ***. Sikurse është detajuar në tabelën e mëposhtme, subjekti ka rezultuar me një balancë pozitive në masën 129.444 lekë.

Tabela nr. 7 – Analiza financiare e burimeve për pagesën e kështit të fundit të njësisë

Te ardhura nga paga e subjektit 1.1.2010 - 7.6.2010	356,800
Te ardhura nga paga e bashkeshortit 1.1.2010 - 7.6.2010	517,800
Te ardhura nga qiradhenia janar - qershor 2010	90,000
Shpenzime jetese 1.1.2010 - 7.6.2010 (4 persona)	(273,240)
Shuma e tërhequr nga kredia ne RZB	2,090,000
Te ardhura nga shitja e apartamentit ne Kukës	1,884,000
Shpenzim per blerje apartamenti ne Kukës	(1,000,000)
Shpenzime mobilimi	(260,000)
Paguar kesti II I njësisë	(3,275,916)
Rezultati në datë 7.6.2010	129,444

132. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për pagesën e kështit të dytë të pasurisë “Njësi shërbimi”.

4. Apartament me sipërfaqe 41 m², me vendndodhje në Kukës, në vlerën 1.000.000 lekë

133. Në DIPP-në e vitit 2010 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë apartament me sip. 41 m², në katin e ***-të, në Kukës, në vlerën 1.000.000 lekë. Kjo pasuri është përfituar me anë të kontratës së porosisë nr. ***, datë 3.3.2010, të nënshkruar me shoqërinë “****” sh.p.k⁶³. Çmimi i blerjes është likuiduar jashtë zyrës së noteriale.
134. Lidhur me mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë, në DIPP-në e vitit 2010, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se ka qenë një harresë që është saktësuar në deklaratën *Vetting*, ku si burim krijimi i pasurisë në analizë janë deklaruar të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme⁶⁴.
135. Komisioni, bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, ka konstatuar se çmimi i shitjes për apartamentet në qytetin e Kukësit, në vitin 2010, ka qenë 30.240 lekë/m². Për rrjedhojë, në referencë të këtyre të dhënave, për një apartament me sipërfaqe 41 m² çmimi do të ishte 1.239.840 lekë.
136. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se ka qenë në pamundësi për të paraqitur kontrata të ngjashme me atë të blerjes së pasurisë nga ana e saj, për shkak se banorët kanë refuzuar t’ia vinin në dispozicion. Ndërsa firma e ndërtimit në QKB-së rezultoi e pezulluar. Subjekti ka sqaruar se blerja e këtij apartamenti ka qenë një okazion. Po ashtu, pozicionimi dhe kushtet specifike të banesës kanë ndikuar në çmimin e këtij apartamenti. Lidhur me arredimin e tij, subjekti është shprehur se janë përdorur disa mobilie modeste në vitin 2012, me vlerë jo më shumë se 200.000 lekë.
137. Ky apartament nuk është konfirmuar nga ASHK Kukës⁶⁵, pasi pasuria ka qenë ende e pahipotekuar.
138. FSHU-ja⁶⁶ ka bërë me dije se në emër të z. S. S. është identifikuar një abonent me kontratë furnizimi nr. *** në qytetin e Kukësit, kontratë e hapur në datën 14.1.2011.

4.1 Analizimi i burimit financiar të përdorur për blerjen e kësaj pasurie

139. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme⁶⁷ dhe asaj të luajtshme (apartamentit dhe orendive shtëpiake). Referuar kontratës me kusht të shitjes së pasurisë së paluajtshme të datës 17.2.2010, pasuria nr. *** do të shitej kundrejt çmimit 1.734.000 lekë, nga të cilat 347.000 lekë është paguar në dorë dhe diferenca prej 1.386.000 lekësh do të paguhej pas miratimit të kredisë palës blerëse. Kontrata për kalimin e pronësisë (pas plotësimit të kushtit të kontratës së datës 17.2.2010) është nënshkruar nga palët në datën 23.3.2010.
140. Bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 3.2.2010 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, çmimi i shitjes në tregun e lirë

⁶³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2023, ka informuar se nuk ka çështje gjyqësore të shqyrtuara prej subjektit të rivlerësimit.

⁶⁴ Sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, të ndodhur në Kukës, me anë të kontratës nr. ***, datë 17.2.2010 dhe të shitjes së pasurisë së luajtshme me anë të kontratës nr. ***, datë 17.2.2010.

⁶⁵ Me shkresën nr. *** prot., date 31.5.2023.

⁶⁶ Shkresa kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.3.2023, si dhe shkresa nr. *** prot., datë 13.5.2024.

⁶⁷ Pasuri, e cila, lidhur me blerjen dhe burimet e krijimit të saj, është trajtuar në pikën/pasurinë nr. 2 të këtij relacioni.

në qytetin e Kukësit ka qenë 27.966 lekë/m², për rrjedhojë, për një apartament me sipërfaqe 73.5 m² do të rezultonte në vlerën 2.055.501 lekë, pra më të lartë se çmimi i aplikuar⁶⁸.

141. Orenditë shtëpiake janë shitur kundrejt çmimit 1.700.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale. E pyetur lidhur me shpenzimet e bëra për mobilimin e shtëpisë që kanë arritur vlerën 1.700.000 lekë, subjekti ka bërë me dije se, përveç shpenzimit prej 150.000 lekësh (të deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 1), ajo ka kryer edhe një riparim të tarracës në shumën 280.000 lekë në vitin 2008 dhe vendosjen e grilave në shumën 260.000 lekë në janar të vitit 2010. Nga sa më sipër, sipas pretendimeve të subjektit, shpenzimet për mobilimin e këtij apartamenti i kanë kushtuar rreth 690.000 lekë.
142. Nuk ka logjikë ekonomike në transaksionet e mësipërme, të kryera nga subjekti, duke shitur apartamentin në një çmim më të ulët se çmimi i referencës dhe se çmimi i blerjes së këtij apartamenti nga vetë subjekti 7 vite më herët, ndërkohë që janë shitur mobiliet dhe orenditë shtëpiake në një çmim më të lartë se vlera e tyre, e shpenzuar nga vetë subjekti.
143. Nisur nga sa më sipër, është konstatuar se çmimet e këtyre shitblerjeve janë përcaktuar duke pasur si qëllim shmangien nga pagimi i detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit. Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare, duke i konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm shumën 1.734.000 lekë nga shitja e pasurisë së paluajtshme dhe shumën 150.000 lekë nga shitja e mobilieve (sa kostoja e tyre). Lidhur me shumën 540.000 lekë, të shpenzuar nga subjekti për riparimin e tarracës dhe grilave, ato janë konsideruar si investime në pasurinë e paluajtshme, të cilat duhet të përfshiheshin në vlerën e shitjes dhe jo veçmas saj (ndonëse subjekti i ka pretenduar këto të ardhura si pjesë e të ardhurave nga shitja e pasurive të luajtshme, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni).
144. Komisioni ka analizuar disponibilitetin financiar të subjektit deri në datën 3.3.2010, kur është nënshkruar kontrata e porosisë nr. ***, për apartamentin në analizë dhe ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament me sip. 41 m², në Kukës, në masën – 515.305 lekë.
145. Në përfundim, lidhur me blerjen e kësaj pasurie dhe për sa u përket burimeve të deklaruara e të përdorura, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova/shpjegime të tjera lidhur me arsyet e blerjes së kësaj pasurie me një çmim më të ulët se çmimi i referencës së EKB-së, si dhe në lidhje me balancën negative të rezultuar në masën -515.305 lekë, për blerjen e pasurisë në analizë – si më sipër.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

146. Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit, subjekti i ka qëndruar të njëjtave shpjegime të paraqitura edhe gjatë hetimit administrativ (pozicionimi, planimetria pa ballkon, vullneti mes palëve kontraktuese etj.).
147. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar rishikimin e analizës financiare, duke përfshirë në të të ardhurat si më poshtë:

⁶⁸ Lidhur me tatimin mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë, subjekti ka deklaruar se në rastin konkret çmimi i shitjes së pasurisë, në krahasim me çmimin e blerjes së tij është më i ulët e, për rrjedhojë, transaksioni nuk është objekt i pagesës së tatimit.

- a) të ardhurat nga qiraja e dyqanit deri në datën 3.3.2010 (janar – shkurt 2010, në vlerën 60.000 lekë në total);
- b) të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme në vlerën 1.700.000 lekë⁶⁹;
- c) të ardhurat nga shpenzimet e kryera në vitet 2008 dhe 2010 në shumat 280.000 dhe 260.000 lekë⁷⁰;
- d) reduktimin e shpenzimeve të jetesës së bashkëshortit si ushtarak;
- e) përdorimin e gjendjes *cash*.

Vlerësimi i trupit gjykues

148. Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit nga subjekti, Komisioni, duke mbajtur në konsideratë faktin se nga hetimi i kryer nuk është verifikuar asnjë rrethanë për konflikt interesi, favorizim apo situata që të ngrenë dyshime gjatë ushtrimit të detyrës përkundrejt subjektit ndërtues, administratorit apo ortakut të tij, trupi gjykues i gjen bindëse shpjegimet e subjektit.
149. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga shitja e pasurive të luajtshme, Komisioni çmon se, në mungesë të provave të së kundërtës, mbetet përtej kufijve të logjikës ekonomike rrethana që mobiliet dhe pajisjet e një apartamenti të mund të shiten në një vlerë pothuajse sa vetë apartamenti, ndonëse aty janë pretenduar edhe punime të kryera (në tarracë, në pjesë të tjera të çmontueshme që janë vlerësuar veç apartamentit). Për rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara nga shitja e mobileve dhe orendive nuk mund të merren në konsideratë përtej shpenzimeve për mobilim (të kryer asokohe) në masën 150.000, të cilat kanë rezultuar të provuara me dokumentacion ligjor. Kësisoj pretendimi i subjektit mbi këtë pikë mbetet i paprovuar.
150. Nga ana tjetër, për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me të ardhurat nga qiraja në shumën 60.000 lekë (për 2 muaj), lidhur me të cilat Komisioni, deri në fazën e rezultateve të hetimit kishte vlerësuar të mos i përfshinte ato në analizë, për shkak se nuk provohej marrëdhënia kontraktore e qirasë. Pas saktësimit nga ana e subjektit, si dhe nga shqyrtimi i kontratës me nr. ***, datë 10.1.2009, ka rezultuar se afati i përcaktuar në kontratë ka qenë deri në datën 11.1.2010. Po ashtu, në kontratë përcaktohej se me mbarimin e kësaj kontrate, palët me vullnet të tyre mund të lidhnin kontratë me afat të ri. Vlera e qirasë ka qenë 30.000 lekë/muaj, vlerë e cila ishte përcaktuar të paguhej brenda datës 5 të çdo muaji. Po ashtu, ka rezultuar se në datën 2.4.2010 z. S. S. ka nënshkruar një kontratë të re qiraje me nr. ***, me afat 2-vjeçar, me vlerë 30.000 lekë/muaj. Edhe pse nuk provohet marrëdhënia kontraktore deri në muajin prill që është nënshkruar kontrata e re, nisur nga pagesa e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga qiraja, të cilat korrespondojnë për të gjithë vitin, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare qiranë për muajt janar dhe shkurt 2010 në shumën 60.000 lekë, për sa kohë që provohet pagesa e tatimit në burim për këto të ardhura.

⁶⁹ Për këto të ardhura, subjekti ka paraqitur një *email* nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, ku bëhet me dije se lidhur me objektet e kërkuara nuk disponoheshin të dhëna për vlerat e tyre; një përgjigje të Shoqatës Kombëtare për Integrim Zhvillim dhe Ndihmë për Shtresat në Nevojë - Artizan.al, ku citohet se: “Çmimi i shitjes së objekteve sixhade varion nga 130.000 - 150.000 lekë; postiqe në varësi të vitit të prodhimit, përmasave dhe materialit, varion nga 50.000 - 80.000 lekë, ndërsa sënduku i drurit për rroba në varësi të drurit të përdorur, gdhendjes dhe gjendjes së tij, varion në një çmim nga 180.000 - 230.000 lekë. Nga përlllogaritja mesatare e 5 objekteve në fjalë (2 sixhade, 2 postiqe dhe sëndukun) rezulton një vlerë mesatare prej 615.000 lekësh”.

⁷⁰ Subjekti ka paraqitur shkresën nr. 336/1 prot., datë 13.6.2024, nga Bashkia Kukës, ku konfirmohet se prej tyre nuk është realizuar asnjë investim, duke përfshirë edhe riparimin e tarracave, si një përgjegjësi kjo e pronarëve të njërive dhe jo e pushtetit vendor.

151. Në këto kushte, *mutatis mutandis*, Komisioni ka kryer korrigjimet në analizën financiare për periudhën 1.1.2010 – 3.3.2010, duke shtuar në të edhe të ardhurat nga qiraja e dyqanit për muajt janar – shkurt 2010 prej 60.000 lekësh, në total. Po ashtu, u reduktuan shpenzimet jetike për bashkëshortin në masën 50%, për shkak të statusit të tij si ushtarak i lartë (si më lart), si dhe u përfshi në analizë gjendja *cash* në vlerën 1.400.000 lekë në vitin 2010⁷¹, e cila nuk ishte përfshirë më herët, pasi nuk ishte specifikuar apo pretenduar nga subjekti si burim i përdorur për krijimin e pasurisë në analizë.
152. Për sa më sipër, në datën e krijimit të pasurisë apartament banimi në Kukës, situata financiare e subjektit nga një balancë negative në masën – 515.305 lekë që ishte në rezultate, paraqitet me balancë pozitive prej 956,080 lekësh, si në tabelën në vijim.

Tabela nr. 8 – Analiza financiare e burimeve për blerjen e pasurisë

Te ardhura nga paga e subjektit 1.1.2010 - 3.3.2010	92,000
Te ardhura nga paga e bashkeshortit 1.1.2010 - 3.3.2010	246,775
Te ardhura nga qirate e dyqanit (2 muaj)	60,000
Shpenzime jetese 1.1.2010 - 3.3.2010 (per 4 persona)	(79,695)
Shpenzime mobilimi janar 2010	(260,000)
Te ardhura nga shitja pasurise se paluajtshme	347,000
Gjendje cash	1,400,000
Te ardhura nga shitja pasurise se luajtshme	150,000
Paguar cmimi apartamentit ne Kukes	(1,000,000)
Rezultati ne date 3.3.2010	956,080

5. Automjet tip “Mercedes-Benz”

153. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar automjetin tip “Mercedes-Benz”, ***, i vitit 2005, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar automjetin në fjalë, të përfitur nëpërmjet kontratës nr. ***, datë 12.3.2012, kundrejt çmimit 600.000 lekë, me burim nga kursimet familjare.
154. Nga DPSHTRR-ja është përcjellë dosja e pasurisë në analizë, ku ndër të tjera ka rezultuar se ka rezultuar se shitësi R. Z. e kishte blerë këtë automjet rreth 2 javë përpara shitjes, me anë të kontratës nr. ***, datë 23.2.2012, në vlerën 10.000 euro⁷².
155. E pyetur lidhur me arsyet e aplikimit të një çmimi më të ulët se çmimi i blerjes – nga pala shitëse, në një periudhë të shkurtër kohore, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti është shprehur se automjeti ka pasur probleme me kambion dhe se ajo nuk ka pasur dijeni mbi çmimin e mëparshëm të blerjes së tij. Gjithashtu, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 4.5.2023, në të cilën shitësi i automjetit R. Z. ka deklaruar se disa ditë pas blerjes së këtij automjeti, ky i fundit ka shfaqur probleme me kambion dhe e ka çuar dy herë në servis, e më pas ka vendosur ta shesë.
156. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni deri në datën 12.3.2012, kur është blerë automjeti, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën – 386.220 lekë.

⁷¹ Nisur nga deklarimi i subjektit në deklaratat periodike për gjendjen *cash*, rezulton se në fund të vitit 2009 gjendja *cash* e akumuluar është në vlerën 2.850.000 lekë. Ndërsa në vitin pasardhës subjekti ka deklaruar pakësimin e saj, duke deklaruar si gjendje të vitit shumë më 1.400.000 lekë.

⁷² Më pas, me anë të kontratës së dhurimit nr. 21/15, datë 5.1.2021, bashkëshorti i subjektit ia ka dhuruar djalit të tij, z. E. S.

157. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova/shpjegime të tjera lidhur me sa vijon:

- *Duket se çmimi i blerjes së këtij automjeti është më i ulët se çmimi i blerjes së tij nga vetë pala shitëse, rreth 2 javë më herët.*
- *Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej – 386.220 lekësh, për blerjen e këtij automjeti, duke konsideruar vetëm të ardhurat e vitit 2012.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

158. Subjekti ka parashtruar se nuk ka pasur asnjë ndikim dhe dijeni për motivet apo arsyet e përcaktimit të çmimeve nga njëri blerës tek tjetri sipas kronologjisë së shitblerjeve, deri në momentin e blerjes së mjetit nga ana e bashkëshortit, kur ky i fundit e ka vënë në dijeni për problemin që mjeti kishte me kambion. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës një përgjigje⁷³ nga subjekti i autorizuar për shitblerjen e këtyre automjeteve në Shqipëri, ku sqarohet përcaktimi i çmimit në varësi të shkallës së amortizimit.

159. Për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme financiare prej -386.220 lekësh, subjekti ka parashtruar se kjo balancë negative ka rezultuar për shkak të mospërfshirjes në analizën e blerjes së automjetit në vlerën 600.000 lekë, të kursimeve *cash* të deklaruara në fund të vitit 2011 në shumën 1.400.000 lekë, shumë e cila është rikrijuar deri në fund të vitit 2012.

Vlerësimi i trupit gjykues

160. Lidhur me çmimin e blerjes së automjetit, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë faktet se: (i) subjekti nuk ka rezultuar më kushtet e konfliktit të interesit; (ii) subjekti ka vënë në dispozicion një shkresë orientuese (nga shoqëria distributor i mjeteve të tipit “Mercedes-Benz”) lidhur me çmimin e shitjes së një mjeti, me parametrat e atij që bashkëshorti i subjektit ka blerë; (iii) bazuar në deklaratën e shitësit, i cili ka konfirmuar si vlerën e shitjes, po ashtu edhe kushtet (problemet) teknike të mjetit në fjalë – vlerëson se nuk mund të konkludohet për trajtim preferencial në blerjen e kësaj pasurie.

161. Për sa i përket pretendimit të subjektit, për konsiderimin e përdorimit të gjendjes *cash* në analizën e krijimit të kësaj pasurie, pretendim ky i parashtruar nga subjekti pas njoftimit të rezultateve të hetimit, trupi gjykues e gjen të bazuar këtë pretendim, për sa kohë referuar deklarimeve të subjektit në DIPP-në e viteve 2010, 2011 dhe 2012, të saktësuara edhe në pyetësonin nr. 3, ka rezultuar se subjekti në fund të vitit 2010 ka disponuar gjendje të kursimeve në shumën 1.400.000 lekë, ndërkohë që në fund të vitit 2009 kishte

⁷³ Shkresa “Kthim përgjigje për informacionin e kërkuar” nr. *** prot., datë 12.6.2024, ku ndër të tjera citohet: “Automjeti tip “Mercedes-Benz”, tipi 163, vit prodhimi 2005, me karburant naftë, e me të dhënat e tjera sikurse referon Leja e Qarkullimit, pas fabrikimit, sipas çmimeve të referuara në katalogët zyrtarë të prodhuesit “Mercedes-Benz” dhe metodologjisë gjerësisht të aplikueshme për konsumin mesatar të automjeteve në qarkullim/përdorim, ka qenë mesatarisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) – 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro. Nëse do të kërkoheshin apo vëreheshin opsione shtesë të operimit, atëherë çmimi i shitjes do të ishte më i lartë. Automjetet e kategorisë sikurse rasti konkret, kanë një kosto mesatare amortizimi të tillë: çmimi ulet në shumën 5.000 (pesë mijë) euro, në momentin e transaksionit fillestar/të parë të tij. Për vitet e mëpasshme çmimi reduktohet 20% për çdo vit, të shumës së mbetur nga viti më i hershëm. Duke përllogaritur çmimin e blerjes në të dyja opsionet si më sipër, automjeti konkret në vitin 2012, do të shitej mesatarisht në shumën 5.242 (pesëmijë e dyqind e dyzetë e dy) euro deri në 6.290 (gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) euro; Vlerat mesatare të shitjes në përgjigje të pyetjes nr. 2 do të jenë të aplikueshme në kushtet kur automjeti paraqet gjendje optimale të tij. Nëse do të kishte probleme të sistemeve të ndryshme, duke përfshirë edhe ato motorike apo të drejtimit, çmimi do të ishte më i ulët”.

disponuar me burime të ligjshme dhe kishte deklaruar rregullisht dhe në kohë reale gjendje *cash* në vlerën 2.850.000 lekë. Në këto kushte, duke qenë se mbetet një diferencë e konsiderueshme gjendjeje *cash* e përdorshme dhe nuk ka shkaqe që mund të përjashtojë këtë mundësi, pra që subjekti të ketë përdorur gjendjen e disponuar *cash*, pretendimi i subjektit vlerësohet i pranueshëm.

162. Për sa më sipër, nga analiza financiare për periudhën 1.1.2012 – 12.3.2012, duke saktësuar financimin e çmimit të automjetit edhe nga kursimet *cash* në familje, subjekti ka rezultuar me një balancë pozitive në vlerën 213.780 lekë, duke u shuar kështu pamundësia e njoftuar me rezultatet e hetimit, prej – 386.220 lekësh, sikurse pasqyrohet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 9 – Analiza financiare e burimeve për blerjen e pasurisë

Te ardhura nga paga e subjektit 1.1.2012 - 12.3.2012	87,300
Te ardhura nga paga e bashkeshortit 1.1.2012 - 12.3.2012	64,000
Shpenzime jetese 1.1.2012 - 12.3.2012 (per 4 persona)	(117,520)
Te ardhura nga qiradhenia	180,000
Shpenzim per blerjen e automjetit	(600,000)
Perdorur nga cash i vitit te kaluar	600,000
Rezultati ne date 12.3.2012	213,780

6. Lidhur me gjendjen e deklaruar *cash* ndër vite

163. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje të disponuar *cash* në banesë, në shumën 500.000 lekë. Nga shqyrtimi i DIPP-ve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite kanë rezultuar deklaratimet e saj mbi gjendjen *cash*, përkatësisht duke filluar në vitin 2005 e duke vazhduar më tej në vitet 2006, 2009, 2010, 2014 dhe 2016.
164. Pasi është pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 3, mbi mënyrën e deklarimit të gjendjes së disponuar *cash* në banesë, subjekti i rivlerësimit ka saktësuar deklaratimet e saj mbi gjendjet *cash* ndër vite, të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim.
165. Nga shqyrtimi i deklaratimeve të subjektit është konstatuar se çdo vit është deklaruar gjendja e parave të kursyera në atë vit me burimet përkatëse të të ardhurave të atij viti. Megjithatë, subjekti nuk ka deklaruar ndryshimet, por gjendjen e vitit përkatës, duke krijuar paqartësi/konfuzion lidhur me mënyrën e deklarimit të gjendjes *cash* ndër vite.
166. Nisur nga sa më sipër, janë evidentuar pasaktësi lidhur me deklarimin e gjendjes *cash* ndër vite (të cilat gjithsesi nuk impaktonin burimet e ligjshme të burimit) lidhur me të cilat subjekti ka dhënë shpjegime/qartësime, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni përgjatë procesit të rivlerësimit. Ndërsa, në prapësimet e saj, pas njoftimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar përdorimin e gjendjes *cash* në vitin 2010 në masën 1.400.000 lekë, si dhe përdorimin e gjendjes *cash* në vlerën 600.000 lekë në vitin 2012, pretendime të cilat janë trajtuar më sipër në analizën financiare të kryer për periudhat përkatëse.
167. Për sa i përket burimeve financiare për krijimin e këtyre gjendjeve *cash*, të gjitha efektet dhe konstatimet përkatëse janë reflektuar edhe në tabelën e përgjithshme të analizës financiare.
168. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara në mënyrën e deklarimit të gjendjeve *cash* nga ana e subjektit nuk mund të përbëjnë shkak për penalizimin e saj, për

sa kohë subjekti nuk ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjeve *cash* të deklaruara.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

169. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
170. Pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruara në vitin përkatës të kryerjes së investimit. Të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëngjitur deklaratës *Vetting*.
171. Shpenzimet jetike janë përlllogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT-i. Shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit, ndërsa shpenzimet e udhëtimit të subjektit nga vendi i ushtrimit të detyrës, në Tiranë (ku jetonte familja e saj), janë përlllogaritur duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit, si dhe tarifat e transportit publik.
172. Gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Kursi i këmbimit i përdorur për të gjitha investimet/shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë. Nga analiza e përgjithshme financiare ku u konsideruan dhe përpunuan të dhënat nga viti 1995 deri në vitin 2016, fillimisht rezultoi një bilanc i përgjithshëm negativ në masën -1.985.637 lekë.
173. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime bindëse dhe dokumentacion ligjor për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, mbi kriterin e pasurisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

174. Subjekti pretendoi që Komisioni të merrte në konsideratë pretendimet e saj, të cilat janë analizuar më herët në mënyrë të detajuar në këtë vendim dhe që në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në: (i) spostimin e pagesës në vitin 2005 për blerjen e apartamentit në Kukës; (ii) përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga qiraja; (iii) reduktimin e shpenzimeve të jetesës për bashkëshortin; (iv) konsiderimin si të ligjshëm të të ardhurave nga qiraja për vitet 1998 – 2000. Sipas subjektit, nëse do të konsideroheshin pretendimet e saj, ajo do të rezultonte me balancë negative në masën - 241.584 lekë. Konkretisht, me një pamundësi financiare në vitin 2007 për shumën 173.037 lekë dhe në vitin 2012 në shumën 68.547 lekë.

Vlerësimi i trupit gjykues

175. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur prej saj, trupi gjykues ka konstatuar se duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit, si më sipër arsyetuar (përveç të ardhurave nga qiraja në shumën 14.600 USD, si dhe duke reduktuar shpenzimet e jetesës për bashkëshortin në masën 50% dhe jo 80% sa ka pretenduar subjekti), rezulton se subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi financiare në vitin 2003 për shumën -187,583 lekë dhe në vitin 2007 në shumën -209,964 lekë.

176. Pas kryerjes së ndryshimeve në analizën financiare është konstatuar se subjekti, në periudhën 1995 – 2016, ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme në masën – 397.457 lekë, për krijimin e pasurive në pronësi të saj, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim.

Analiza financiare për periudhën 1995 – 2016

Viti	1995-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	4,739,352	1,195,669	5,353,719	1,034,357	145,585	-42,277	744,376	2,857,261	-46,058	585,594	-1,118,432	-28,124	72,915	199,283
Automjet M. Benz TR***F	415,800													
Apartament banimi Kukes 73.5 m2			2,000,000											
Apartament banimi P. Aginii, Tirane	3,000,000													
Njesi shtermbini			4,901,600					3,275,916						
Apartament banimi Kukes								1,000,000						
Automjet M. Benz ML270										600,000				
Ndryshim likuiditeti	1,323,552	1,195,669	-1,547,881	1,034,357	145,585	-42,277	744,376	-1,418,655	-46,058	-14,406	-1,118,432	-28,124	72,915	199,283
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	1,323,552	2,519,221	971,340	2,005,697	2,151,282	2,109,005	2,853,380	1,434,726	1,388,668	1,374,262	255,830	227,706	300,620	499,904
DETYRIME	0	2,000,000	4,901,600	0	3,000,000	-1,000,000	-1,000,000	2,200,000	0	0	0	0	0	0
Kredi ne Banken e Kursimeve		2,000,000												
Kredi ne BKT			4,901,600											
Hua nga z. A.S.					3,000,000	-2,000,000	-1,000,000							
Kredi ne RZB per shlyerje borzhi						1,000,000								
Kredi ne RZB								2,200,000						
PASURI NETO	4,739,352	-804,331	452,119	1,034,357	-2,854,415	957,723	1,744,376	657,261	-46,058	585,594	-1,118,432	-28,124	72,915	199,283
TË ARDHURA dokumentuar	6,880,804	1,549,528	2,134,174	2,912,604	2,440,234	2,645,158	2,806,615	4,791,184	2,204,516	2,080,285	1,671,416	2,434,513	2,253,380	2,233,713
Te ardhura nga paga e subjektit	3,357,332	647,750	795,884	1,004,411	861,006	933,893	1,040,948	1,043,250	1,055,175	1,082,941	1,093,640	1,276,737	1,303,604	1,283,937
Te ardhura nga paga e b'shortit	3,523,472	832,257	948,399	1,128,193	949,228	1,471,265	1,405,667	1,173,934	449,341	256,604	-	-	-	-
Te ardhura nga pensioni parakohshem b'shortit									140,740	337,776	337,776	337,776	337,776	337,776
Te ardhura nga qiradhenia				420,000	270,000	240,000	360,000	540,000	700,000	600,000	240,000	720,000	612,000	612,000
Te ardhura nga interesat bankare		69,521	29,891											
Te ardhura nga shiija e apartamentit								1,884,000						
Te ardhura nga shiija e mobiljeve								150,000						
Te ardhura nga shiija e automjeteve											100,000			
Te ardhura nga gazetaret spanjolle														
Te ardhura nga qiradhenia e apart. TR			360,000	360,000	360,000									
SHPENZIME	2,329,035	822,507	1,029,770	1,716,432	5,504,613	1,061,209	908,315	3,146,663	1,734,932	1,383,238	1,167,305	1,897,467	1,966,450	1,900,669
Shpenzime jetese	2,329,035	422,388	493,007	493,007	553,898	546,480	478,170	478,170	478,170	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime mobilimi		150,000		200,000		280,000		260,000	300,000	200,000				
Shpenzime shendetesore				130,000				820,000						
Shpenzime udhëtimi		164,762	48,281	3,958	0	15,767	62,408	65,600	480,500	148,812	138,339	571,821	634,792	433,540
Shpenzim per siguracion automjeti														19,717
Shpenzime te kredise ne BKT			374,648	775,636	4,836,872									
Shpenzime arsimimi														9,800
Shpenzime te kredive ne RZB						105,060	253,870	1,409,006	362,434	356,475	351,031	331,809	320,872	314,329
Shpenzime te kredise ne B.Kursimeve & RZB		85,357	113,836	113,831	113,843	113,902	113,867	113,887	113,828	113,854	113,839	113,844	113,681	113,915
Shpenzime per tatimin e qirase														69,000
Analiza dokumentuar	-187,583	1,531,352	652,284	161,816	-209,964	626,226	153,925	987,260	515,641	111,453	1,622,543	565,170	214,016	133,760
DIFERENCA E PA MBULUAR			-397,547											

177. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se balanca negative në shumën totale prej - 397.547 lekësh shpërndahet në dy vite (2003 dhe 2007) në vlera jodomethënëse, të cilat nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit.

178. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, ky i fundit ka disa pasaktësi në deklarime dhe ka mungesë të ardhurash për dy vjet, të cilat nuk janë në atë shkallë sa të përbëjnë shkaqe për shkarkimin e saj nga detyra. Kjo balancë negative nuk u vlerësua se duhet të krijojë një përgjegjësi disiplinore për subjektin e rivlerësimit, për pasojë, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

179. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit Vjollca Spahiu – të përpiluar pa disponimin e përgjigjes prej njëres prej organeve ligjzbatuese – me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit.
180. Më pas, me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2018, është përcjellë informacion shtesë për këtë subjekt, ndërsa me shkresat nr. *** prot., datë 29.6.2022, nr. *** prot. dhe *** prot., datë 10.7.2023, i është bërë me dije Komisionit se nuk disponoheshin të dhëna të përditësuara e administruara për këtë subjekt rivlerësimi, pas vitit 2018.
181. Ndërkohë, më tej, me shkresë AKSIK-ja i ka (ri)përcjellë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, të përditësuar dhe të rishikuar, më 14.11.2023, me nr. protokollin ***, nëpërmjet të cilit është ndryshuar konstatimi fillestar për këtë subjekt, nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës – pasi ka pasur dyshime se në vitin 2006 (përgjatë periudhës që subjekti ushtronte detyrën e gjyqtarës) ka ushtruar ndikim të paligjshëm dhe/ose është përfshirë në një marrëdhënie korruptive të një prokurori, në sistemin e drejtësisë.
182. Gjithashtu, me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2023, AKSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar pjesërisht, në datën 16.11.2023 me vendimin nr. *** të KDZH-së.
183. Në vijim dhe vlerësim të të dhënave që disponoheshin lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, nisur nga informacionet e përcjella nga organet ligjzbatuese dhe pasi janë aksesuar informacionet e klasifikuara pranë organit kompetent, në përputhje me nenin 41, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një hetim administrativ gjithëpërfshirës, duke kërkuar informacione dhe dokumentacione shtesë.
184. Gjithashtu, janë administruar dhe analizuar disa akte, vendime e dosje, që lidheshin me çështjet gjyqësore, me qëllim verifikimin e të dhënave konfidenciale të raportuara dhe/ose të bëra me dije edhe nëpërmjet aksesimit të dokumenteve e informacioneve të klasifikuara, që lidheshin me kriterin e figurës.
185. Nisur nga sa më sipër, nëpërmjet shkresës nr. *** prot. dhe nr. *** prot., datë 12.6.2023, Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, si dhe Prokurorisë së Rrethit Kukës informacion dhe dokumentacion shtesë për të kryer verifikimet e nevojshme. Në vijim, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës⁷⁴ dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës⁷⁵ kanë përcjellë dokumentacionin e kërkuar nga i cili, pasi është analizuar, ka rezultuar sa vijon:
- i) Në lidhje me vendimin penal nr. ***, datë 16.12.2013, me të dyshuar shtetasin H. K., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal.**

⁷⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 29.6.2023.

⁷⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 20.6.2023.

186. Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 16.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës⁷⁶, ka rezultuar se çështja nuk është shqyrtuar nga subjekti, por nga një tjetër gjyqtar (I. Sh.)⁷⁷. Për rrjedhojë, nuk gjenden elemente që konfirmojnë dyshimet për veprime që mund të kenë favorizuar personin nën hetim nga ana e subjektit të rivlerësimit.
187. Gjithsesi, Komisioni, duke qenë se ngriheshin dyshime nga informacionet e klasifikuara se bëhej fjalë për një të afërm të subjektit, i cili mund të përbënte hipotetakisht kontakt të papërshtatshëm (në funksion të shkallës së afërsisë familjare dhe të llojit të dënimit të dhënë), i kërkoi subjektit shpjegime nëpërmjet pyetësorit nr. 5 dhe vlerësoi dokumentacionin e administruar. Në përgjigje të këtij pyetësoi, subjekti u shpreh se nuk e njihte dhe nuk ka pasur ndonjë kontakt apo komunikim me shtetasin e përmendur në çështjen e trajtuar më sipër (H. S. K.).
188. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se nga informacionet e marra nga të afërmit e saj është vënë në dijeni lidhur me një lidhje të largët farefisnore (në shkallën e katërt) me një shtetas me të dhënat H. R. K., për të cilin është shprehur se nuk e njihte. Subjekti ka parashtruar se në Kukës janë tre fise të ndryshme me mbiemër K. dhe se ekzistojnë tre shtetas me emër dhe mbiemër H. K., por me atësi dhe ditëlindje të ndryshme.
189. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit, Komisioni shqyrtoi dokumentacionin e administruar dhe kreu verifikimin e të dhënave të personit në fjalë (të përfshirë në të dhënat e gjendjes civile), duke i krahasuar ato me të dhënat e personit të dënuar, si kontakt i papërshtatshëm i mundshëm (i cituar në vendimin nr. ***, datë 16.12.2013), nga ku rezultoi se bëhet fjalë për shtetas të ndryshëm.
190. Për rrjedhojë, nisur nga mospërputhja e gjeneraliteteve mes personit të farefisit të subjektit dhe atij në cilësinë e të dënuarit për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, duket se nuk ka dyshime për një kontakt të papërshtatshëm me subjektin e rivlerësimit. Kjo edhe për faktin se kjo vepër nuk parashikohet mes atyre që do të cilësonte autorin si një person të papërshtatshëm.

ii) Lidhur me vendimin penal nr. *, datë 17.7.2003, me shtetasin Y. K.**

191. Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës⁷⁸ dokumentacionin që i përket çështjes gjyqësore nr. *** akti, me të pandehur shtetasin Y. K., i akuzuar për veprat penale “Vrasje me dashje” dhe “Armëmbajtje pa leje”. Nga analizimi i dokumentacionit të disponuar ka rezultuar sa vijon:
192. Prokuroria e Rrethit Kukës me konkluzionet përfundimtare ka kërkuar në Gjykatë: deklarin fajtor të shtetasit Y. K. për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” të shtetas L. K. dhe dënimin e tij me 14 vjet burgim; deklarin fajtor për veprën penale “Armëmbajtje pa leje” dhe dënimin e tij me 1 vit burgim; në aplikim të nenit 155 të Kodit Penal është kërkuar përcaktimi i dënimit për disa vepra penale, duke u bërë bashkimi i dënimeve në masën me 14 vjet burgim.

⁷⁶ Konstatohet se në faqen nr. 4 të vendimit paragrafi nr. 4, emri i të akuzuarit është shkruar gabim.

⁷⁷ Në këtë çështje, Prokuroria e Rrethit Kukës ka kërkuar në gjykatë “Deklarimin fajtor të shtetasit dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Gjykata ka vendosur: “Deklarimin fajtor të shtetasit H. K. dhe dënimi e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimisht me 2 vjet burgim”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 23.4.2014.

⁷⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2023.

193. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, nëpërmjet trupit gjykues, anëtare e të cilit ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit Vjollca Spahiu, me vendimin nr. ***, datë 17.7.2003, ka arritur gjithashtu në përfundimin se i pandehuri Y. K. ka konsumuar plotësisht të gjithë elementët e veprave penale “Vrasje me dashje” dhe “Armëmbajtje pa leje”, të parashikuara nga dispozitat e neneve 76⁷⁹ dhe 278/2 të Kodit Penal⁸⁰ të vitit 2003. Në përfundim, Gjykata ka vendosur: *Deklarimin fajtor të shtetasit Y. K. për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje”, duke e dënuar atë me 11 vjet burgim, si dhe deklarimin fajtor për veprën penale “Armëmbajtje pa leje” dhe dënimin e tij me 1 vit burgim. Në përfundim, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal të bashkimit të dënimeve, shtetasi Y. K. është dënuar përfundimisht nga kjo gjykatë në bashkim të dënimeve, me 11 vjet burgim”.*
194. Vendimi i lartpërmendur është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 27.11.2003, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. 94, viti 2003, duke “Pushuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit Y. K. , të akuzuar për veprën penale “Vrasje me dashje” sipas nenit 76 të Kodit Penal. Lënien në fuqi të vendimit për cilësimin ligjor të deklarimit fajtor për veprën penale “Armëmbajtje pa leje”, ndryshimin e masës së dënimit në aplikim të nenit 278/2, dënimin e tij me 1 vit e 8 muaj burgim”.* Ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs nga Prokuroria, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.
195. Gjykata e Lartë, pasi ka dëgjuar prokurorin, i cili ka relatuar se ndërkohë i pandehuri Y. K. kishte ndërruar jetë, me vendimin nr. ***, datë 10.11.2004, ka vendosur: *Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Y. K. për akuzën “Vrasje me dashje të personit”, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe “Mbajtje pa leje e armëve luftarake” të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.*
196. Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerëson se (pa dashur të zëvendësojë logjikën vlerësuese, në themel dhe mbi masën e dënimit më të përshtatshëm në rastin konkret) në raport me shqyrtimin nuk janë konstatuar problematika/shkelje procedurale apo arsytim i dobët/i paplotë i vendimit, që mund të konfirmojë dyshimet mbi favorizim të palës në këtë proces nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë dënimi i dhënë nga Gjykata, ku ajo ka qenë anëtare e trupit gjykues, rezulton brenda marzhit sasior të parashikuar nga legjislacioni për veprat penale përkatëse – pavarësisht faktit se ky vendim (i subjektit) madje rezulton edhe më i ashpër (ndaj personit të dyshuar – si të “favorizuar”), krahasuar me vendimin që është dhënë më pas, për të njëjtat fakte, nga Gjykata e Apelit Shkodër, duke e ndryshuar vendimin e subjektit si më sipër është përshkruar dhe duke zbritur dënimin për personin në fjalë nga 11 vite burg në një vit e 8 muaj.
197. Në këto kushte, nuk gjenden elemente të mjaftueshme për të konfirmuar dyshimet e ngritura.

iii) Lidhur me vendimin penal nr. *, datë 24.10.2014, lidhur me shtetasin M. Sh.**

198. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga Gjykata⁸¹ dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës⁸² ka rezultuar se në

⁷⁹ Neni 76, “Vrasja me dashje dhe vrasja e kryer me dashje dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”.

⁸⁰ Neni 278 “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit (shtuar paragrafët I dhe II me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998, neni 2. Ndryshuar paragrafi I, II dhe III, si dhe shtuar paragrafi IV me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, neni 60).. Mbajtja e armëve, bombave apo minave, lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.

⁸¹ Bashkëlidhur edhe procesverbalet e seancave gjyqësore për këtë çështje.

⁸² Shkresa nr. *** prot., datë 20.6.2023.

shqyrtimin e çështjes gjyqësore në ngarkim të shtetasit M. SH., subjekti ka qenë pjesë vetëm në një segment kohor të caktuar sikurse parashtrohet në vijim:

199. Në datën 27.12.2013, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në ngarkim të disa shtetasve⁸³, përfshirë edhe shtetasin M. Sh. Ky i fundit ishte i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Kontrabandë me mallra të tjera” në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 174 dhe 25 të Kodit Penal, duke i kërkuar gjykatës “Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit M. Sh.”.
200. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. ***, datë 28.12.2013, të marrë nga gjyqtarja D. V., ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit, duke vendosur masën e sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, vendim që ka marrë formë të prerë.
201. Më tej, ka qenë Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës që, më 25. 2.2014, ka dërguar kërkesën për gjykim të çështjes penale nr. ***, viti 2013, për shtetasin M. Sh. për kryerjen e veprës penale “Kontrabandë nga punonjës që lidhen me veprimtaritë doganore” të parashikuar nga nenet 175 dhe 25 të Kodit Penal, duke ndryshuar cilësimin e veprës penale pas hetimeve dhe rrethanave të reja nga neni 174⁸⁴ në nenin 175 të Kodit Penal (vepër penale kjo për të cilën masa e dënimit është një masë më e madhe dënimi, pasi ajo varion nga 3 gjer në 10 vjet burgim).
202. Referuar procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 19.3.2014, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Vjollca Spahiu ka qenë gjyqtare e çështjes. Në këtë seancë, prokuroria i ka kërkuar gjykatës të urdhërojë OPGJ-në të bënte kërkimin e të pandehurit N. Sh., kërkesë që është pranuar nga subjekti. Seancat e radhës, të datave 2.4.2014, 9.4.2014, 21.4.2014, 30.4.2014 dhe 15.5.2014, janë shtyrë nga subjekti me kërkesë të Prokurorisë për shkak të mungesës së njërit prej të pandehurve, njoftimit të tij, si dhe administrimit të aktit origjinal (në formën e kërkuar nga ligji) të përfaqësimit të të pandehurit N. Sh. (i cili ishte duke vuajtur një dënim ndërkohë dhe nuk mund të paraqitej), si dhe për shkak të mosparaqitjes së avokates së tij. Seanca e datës 26.5.2014 është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së prokurorit. Në seancën e datës 4.6.2014, avokatja e të pandehurve M. Sh. dhe N. Sh. ka paraqitur kërkesë për ndarjen e çështjes për efekt shpejtësie gjykimi. Kjo kërkesë është pranuar nga subjekti.
203. Në seancën e radhës së datës 11.6.2014 avokati i të pandehurit I. C. ka kërkuar gjykimin e zakonshëm për të pandehurin që përfaqësonte dhe, për rrjedhojë, të behej veçimi i çështjes së të pandehurit M. Sh., për të cilin ishte kërkuar më herët nga avokatja e tij gjykimi i shkurtuar. Prokurori është shprehur dakord me kërkesën dhe kjo kërkesë është pranuar nga gjykata. Seanca e datës 17.6.2014 është shtyrë me kërkesë të të pandehurit për shkak të mosparaqitjes së avokates së tij. Në seancën e datës 23.6.2014 subjekti ka arsyetuar se, pasi ka pranuar kërkesën e të pandehurit për veçimin e çështjes, ka konstatuar se vepra penale për të cilën ai akuzohej (nenet 175-25 të K. Penal) parashikon dënim nga 3-10 vjet burgim dhe gjykimi i kësaj çështjeje duhet të bëhet me trup gjykues me 3 gjyqtarë. Me vendimin e ndërmjetëm bazuar në nenin 93/2 të Kodit të Procedurës

⁸³ Xh. V.; I. C.; F. K.; E. M. dhe N. Sh.

⁸⁴ “Gjatë hetimit ishte provuar se shtetasi M. Sh. ushtron detyrën e doganierit në pikën doganore Morinë sipas procesverbalit, çka ka shërbyer si shkak për ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga neni 174 në nenin 175. Referuar Kodit Penal, të pandryshuar, dënohet me burgim deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”.

Penale⁸⁵, subjekti e ka shtyrë seancën për në datën 2.7.2014, me qëllim plotësimin e trupit gjykues.

204. Në vijim, çështja gjyqësore në ngarkim të të pandehurit M. Sh. është shqyrtuar nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët I. Sh., F. H., dhe G. Q. (subjekti nuk ka qenë anëtare). Ky trup gjykues me vendimin nr. ***, datë 24.10.20214, ka arsyetuar ndër të tjera se i pandehuri nuk ka qenë në detyrë, pra mungon dashja e drejtpërdrejtë dhe qëllimi i fitimit, pasi nuk ka kryer asnjë veprim për ta shmangur nga detyrimet doganore shtetasin N. Sh., pra ai nuk është subjekt i veprës penale për të cilën akuzohet. Në përfundim, gjykata ka vendosur “Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit M. Sh., për veprën penale “Kontrabanda nga punonjësi që lidhen me veprimtarinë doganore” ...”. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 5.3.2015. Ndaj këtij të fundit është paraqitur rekurs nga Prokuroria, por nga Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 23.6.2016, nuk është pranuar rekursi.
205. Për sa më sipër, Komisioni vëren se nisur edhe (kryesisht) nga fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e trupës vendimmarrëse – në lidhje me shqyrtimin e çështjes ndaj personit që dyshohet se ka qenë i favorizuar në raport me këtë gjykim/procedim – duke parë edhe vijimësinë e mëtejshme të kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit dhe të Lartë (si më lart), vlerësohet se nuk konstatohen rrethana apo elemente të mjaftueshme për të konsideruar si të konfirmuara dyshimet e ngritura për favorizim të mundshëm nga ana e subjektit, me përfitues pikërisht shtetasin M. Sh.
206. Ndërsa, sa i përket kërkesës së Komisionit për administrimin e vendimeve/dokumenteve/dosjeve lidhur me gjykimin e të dyshuarit Sh. T. – për të cilin kishte referime/*indicie* nga informacionet e klasifikuara – Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2023, ka informuar se sipas verifikimit në arkivën e Gjykatës nuk ka rezultuar të këtë vendim penal apo çështje në lidhje me këtë shtetas.
207. Më pas, me shkresën e datës 8.2.2024, Komisioni i rikërkoj Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës informacion dhe dokumentacion lidhur me çështjen e lartpërmendur. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, me shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2024, Gjykata ka bërë me dije se nga verifikimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe verifikimi i regjistrave fizikë për shtetasin Shkëlqim Tahiri, nuk ka rezultuar të këtë pasur ndonjë proces gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë, të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kukës.
208. Pavarësisht se Komisioni nuk i ka kërkuar subjektit shpjegime lidhur me kriterin e figurës, subjekti ka paraqitur disa argumente, të cilat citohen më poshtë:
209. Subjekti ka parashtruar se 2 nga 3 çështjet e sipërpërkruara janë gjykuar nga trupa të tjera gjykuese. Në asnjë nga këto çështje nuk kanë rezultuar veprime favorizuese. Për rrjedhojë nuk verifikohet asnjë nga elementët për të ngritur dyshime për papërshtatshmëri në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit, konform parashikimeve të neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

⁸⁵ Neni 93/2 i Kodit të Procedurës Penale: “Përveç rasteve të parashikuara nga paragrafi 1 ndarja mund të vendoset edhe me marrëveshje të palëve, kur gjykata e çmon të dobishme për qëllimet e shpejtësisë së gjykimit”.

C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale nga KLGJ-ja

210. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Vjollca Spahiu, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
211. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime, të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
212. Raporti i përcjellë nga KLGJ-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, si: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.
213. Nga të dhënat që ndodhen në sektorin e burimeve njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk ka rezultuar të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit Vjollca Spahiu.

C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

214. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin përkatës dhe përgjithësisht nuk ka konstatuar problematika në lidhje me tri dokumentet ligjore të depozituara prej subjektit dhe me pesë dosjet e shortuara, përveç dosjes nr. ***, për të cilën KLGJ-ja ka parashtruar në raport se vendimi nr. ***, datë 24.5.2016, i dhënë nga subjekti është prishur nga Gjykata e Apelit me vendimin e saj nr. ***, datë 17.1.2018.
215. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar⁸⁶, është konstatuar se Gjykata e Apelit pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e prokurorit i cili kishte kërkuar prishjen e vendimit të sipërcituar, ka konstatuar se kishte shkaqe që nuk e lejonin vazhdimin e këtij procedimi penal edhe në këtë fazë gjykimi. Kjo, pasi bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 141/2016 datë 22.12.2016 “Për dhënie amnistie” pushohej ndjekja penale për çështjet në hetimin dhe shqyrtimi i çështjeve në proces gjyqësor, për veprat penale të kryera deri në datën 25.12.2016. për rrjedhje, Gjykata e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të dhënë nga subjekti. Në këto kushte, ka rezultuar se arsyeja e prishjes së vendimit ka qenë për shkak të ligjit dhe jo për shkelje procedurale apo mangësi nga ana e subjektit.
216. Gjithashtu, lidhur me disa konkluzione të arritura nga KLGJ-ja, megjithëse të pacilësuar si ndikues/penalizues ndaj ndonjë prej indikatorëve të kriterit të aftësive profesionale, është konstatuar sa vijon:
217. Në lidhje me dosjet nr. 1 (çështja penale nr. *** regj., datë 21.4.2015) dhe nr. 2 (çështja penale nr. *** regj., datë 21.7.2015), nga KLGJ-ja është konkluduar se dosjet e këtyre

⁸⁶ Komisioni ka administruar vendimin nr. *** prot., datë 23.3.2023, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

çështjeve janë dorëzuar në sekretari tej afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale (konkretisht pas 6 dhe 7 ditësh nga shpallja e vendimit).

218. Pavarësisht se Komisioni nuk i ka kërkuar shpjegime, subjekti ka parashtruar se neni 113 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se: *“1. Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda 5 ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshëm njoftohen dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim”, i referohet akteve të përgjithshme që përpilon gjykata në formën e kërkesave, urdhërimeve apo vendimeve, të ndryshme nga ato mbi themelin e çështjes. Ndërsa afatet e njoftimit të vendimmarrjes përcaktohen në nenin 382 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: “ ... 2. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; 3. Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. 3. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatë”*. Pra, subjekti nuk ka qenë në shkelje të afateve procedurale për zbardhjen e vendimeve.
219. Po ashtu, edhe në lidhje me dosjen nr. 3 (çështja penale nr. *** regj., datë 9.11.2015) për të cilën KLGJ-ja ka konkluduar se kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 5 muaj e 14 ditë, në intervalin 10.11.2015 – 24.5.2016, për rreth 6 muaj e 10 ditë, pra jashtë afatit standard 4-mujor (kundërvajtje) të caktuar nga pika 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka parë të nevojshme të parashtrorë se: Çështja në fjalë ka pasur për objekt një krim dhe jo kundërvajtje, pavarësisht marzhit dhe llojit të dënimit që parashikohet si sanksion. Për rrjedhojë, në bazë të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit (i parashikuar si standard referimi nga KLGJ-ja), në pikën 5/a të tij parashikohet si periudhë mesatare gjykimi afati 4-mujor për kundërvajtjet penale dhe 9 muaj për krimet. Ndërkohë që kohëzgjatja e gjykimit në rastin konkret ka qenë 6 muaj e 10 ditë, pra është përfunduar brenda afatit 9-mujor që mesatarisht duhet të shqyrtohet një krim.
220. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se afatet e përcaktuara nga ish-KLD-ja janë afate orientuese dhe jodetyruese. Afatet ligjore të gjykimit, detyruese, janë vetëm ato të caktuara në ligjin e posaçëm (Kodit të Procedurës Civile). Megjithatë, sikurse është parashtruar më sipër, nuk ka rezultuar shkelje e afateve procedurale nga ana e subjektit.
221. Ndërsa, lidhur me ankesat e bëra ndaj subjektit, mbi ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën “Kthim përgjigje”⁸⁷ ka konfirmuar se nuk kanë rezultuar çështje penale/civile të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit për shtetasit/personat fizikë⁸⁸ dhe të njëjtin informacion ka bërë me dije edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës⁸⁹ dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹⁰.

⁸⁷ Po aty.

⁸⁸ V. M., H. E., H. H., K. Q., T. V. L., L. L., V. L., G. /G. L. dhe shoqëritë “****” sh.p.k., “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k.

⁸⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 23.3.2023, shtetasit, A. S., N. Sh., S. M., Sh. M., L. L., M. K., Sh. D., K. D., A. T., Shoqëria *** , L. C., H. D., R. Z., M. M., F. S., E. Ç., L. Sh., E. Sh., D. Ç., A. R., E. D., A. M., M. Xh., D. V., I. C., E. K., A. G., A. Z., si dhe shkresa nr. *** prot., datë 27.4.2023, ka informuar se nuk ka asnjë çështje të gjykuar në emër të shtetasit R. L.

⁹⁰ Shkresat nr. *** prot., datë 29.3.2023 dhe nr. *** prot., datë 3.4.2023.

DENONCIME NGA PUBLIKU

222. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku gjithsej 10 denoncime dhe një informacion mbi një vlerësim pozitiv, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Lidhur me këto denoncime, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Nga shqyrtimi i denoncimeve që janë paraqitur nga publiku si dhe shkrimeve publike, Komisioni ka konstatuar sa më poshtë:

1. Denoncimi nr. * prot., datë 12.12.2017, nga shtetasi V. Ç.**

223. Shtetasi V. Ç. në ankesën/denoncimin e paraqitur nuk referon ndonjë informacion/dokumentacion apo ndonjë e dhënë konkrete për subjektin e rivlerësimit, ndonëse përmenden shumë emra subjektësh.

224. Gjithashtu, vërehet se ky denoncim është marrë disa herë në shqyrtim nga Komisioni lidhur me subjekte të tjera e, në përfundim, nuk ka rezultuar ndonjë shkak për thellimin e hetimit.

225. Për sa më sipër, ky denoncim nuk mund të shqyrtohet më tej nga Komisioni, për sa kohë ai nuk i përmbush kushtet e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

2. Informacioni nr. * prot., datë 20.3.2023, nga shtetasja E. C.**

226. Shtetasja E. C. ka përshkruar në këtë njoftim/informacion vlerësimin e saj pozitiv ndaj subjektit të rivlerësimit Vjollca Spahiu, për korrektësinë dhe profesionalizmin e saj përgjatë zhvillimit të procesit gjyqësor.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 23.5.2022, i shtetasit R. Z.**

227. Denoncuesi ka pretenduar se vendimi i dhënë nga gjyqtarja ka qenë në kapërcim të objektit të kërkesës së prokurorit. Po ashtu, ai ka ngritur pretendime lidhur me elementet formale të vendimit, të tilla si numri, data e regjistrimit, nënshkrimi i gjyqtares dhe vula e institucionit.

228. Nga shqyrtimi i “vendimit për bashkim të dënimeve⁹¹ me nr. *** akti, datë 25.5.2017”, objekt denoncimi, i administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹², u konstatua se: *Subjekti, pasi ka bërë analizën dhe arsyetimin juridik, bazuar në nenet 55 dhe 56 të Kodit Penal, ka vlerësuar se kërkesa e organit të akuzës duhej pranuar. Ajo ka vendosur bashkimin e dënimeve penale në bashkimin aritmetik sipas kërkesës së akuzës⁹³, në ngarkim të denoncuesit dhe caktimin e një dënimi të vetëm me 15 vjet e 8 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. *** , datë 20.12.2018, e cila ka ulur dënimin e tij në 11 vjet e 6 muaj burgim.*

229. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se për sa i përket dispozitivit të vendimit, në të cilin, ndryshe nga sa ka pretenduar denoncuesi, është disponuar vetëm për bashkimin e dënimeve. Për sa i përket aspektit formal të vendimit, rezultoi se vendimi i plotësonte elementet formale, pra me numër regjistri, datë dhe nënshkrimin e gjyqtares.

⁹¹ Dënime të dhëna sipas vendimit penal prej 10 vjet burgim, dhënë me vendimin nr. *** , datë 20.11.2011, që ka marrë formë të prerë më 15.12.2021, si dhe dënimin penal prej 6 vjet e 8 muaj burgim të dhënë me një vendim të formës së prerë nr. *** , datë 12.3.2012.

⁹² Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2023.

⁹³ Në vendimin e dytë të dhënë nga gjykata për denoncuesin ka rezultuar se i është ulur të dënuarit/denoncuesit 1 vit burgim nga vuajtja, për shkak të përfitimit nga ligji i amnistisë, neni 4, pika 3 e ligjit nr. 22/2016.

230. Për sa më sipër, pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar të pabazuara e, për rrjedhojë, nuk mund të mbahen në konsideratë në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

4. Denoncimi nr. * prot., datë 28.5.2022, i shtetasit R. Z.**

231. Denoncuesi ka pretenduar se subjekti i ka kërkuar përfaqësuesit të tij në gjykim të kërkonte përjashtimin e saj nga gjykimi. Ai ka pretenduar gjithashtu se subjekti nuk ballafaqoi provat dhe i dha fund hetimit gjyqësor, duke mos marrë dëshminë e shtetasit Y. D., të kërkuar nga i pandehuri/denoncuesi.

232. Nga shqyrtimi i procesverbalit të datës 12.6.2020⁹⁴ ka rezultuar se përfaqësuesi i denoncuesit ka kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit⁹⁵, kërkesë, e cila pasi është shqyrtuar nga gjyqtarja O. G., nuk është pranuar⁹⁶. Në seancën gjyqësore të datës 26.9.2020, përfaqësuesi i të pandehurit ka parashtruar disa kërkesa për pavlefshmëri të akteve lidhur me të cilat subjekti ka vlerësuar se ato nuk ishin ngritur në fazën e duhur, sikurse përcakton Kodi i Procedurës Penale. Megjithatë, subjekti kryesisht bazuar në nenet 356 dhe 357 të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur të marrë për shqyrtim provat e kërkuara nga palët, përveç pyetjes së dëshmitarit Y. D. të ekspertëve mjekoligjorë dhe ekspertëve që kishin hartuar aktin autotenik, me arsyetimin se provat shkresore nuk provohen me dëshmitarë, por ato mund të goditeshin për pavlefshmëri. Po ashtu, subjekti ka vlerësuar se aktet e ekspertimit i kanë dhënë përgjigje shkencore pyetjeve të caktuara nga ana e Gjykatës dhe ishin të sakta dhe nuk linin vend për ekuivoke.

233. Në seancën e datës 5.11.2020, i pandehuri ka paraqitur një kërkesë të re për administrimin e deklaratës noteriale të dëshmitarit okular Y. D., si dhe një material, që, sipas tij, hidhte poshtë konkludimet e ekspertëve. Lidhur me këtë kërkesë, subjekti bazuar në nenin 378/a të Kodi i Procedurës Penale, që referon fazën në të cilën ndodhej procesi gjyqësor, ka çmuar se kërkesa (e ngritur në fazën e konkluzioneve përfundimtare të gjykimit) ishte e pabazuar në prova dhe në ligj, për aq kohë sa deklarata noteriale e shtetasit Y. D. ka kishte qenë pjesë e fashikullit hetimor⁹⁷. Ndërsa lidhur me marrjen e ekspertëve për ballafaqim, subjekti është shprehur se Gjykata e kishte orientuar prokurorin për ribërjen e aktit të ekspertimit dhe nuk shihej e nevojshme thirrja e një eksperti.

234. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 10.3.2021, ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij me 1 vit burgim. Vendimi në fjalë është ankimuar dhe çështja është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit. Komisioni ka konstatuar se subjekti ka marrë vendim lidhur me kërkesat procedurale⁹⁸ në fazën e hetimit. Po ashtu, vendimmarrja përfundimtare lidhur me çështjen i është komunikuar edhe të pandehurit/denoncuesit, si dhe përfaqësuesit të tij ligjor.

⁹⁴ Fillimisht iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 3.5.2023, informoi se çështja është në statusin e ankimuar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në vijim, u administrua dokumentacioni nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2023.

⁹⁵ Kërkesa për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit me argumentin se avokati dhe bashkëshorti i gjyqtarës kanë punuar së bashku, duke e konsideruar shkak për përjashtimin e saj.

⁹⁶ Në dosje rezultojnë të jetë edhe kërkesa me shkrim e subjektit të rivlerësimit.

⁹⁷ Në seancën e datës 16.9.2020, pasi ka deklaruar të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe ka kërkuar paraqitjen e kërkesave dhe provave nga palët që të merren në shqyrtim – ku ka qenë edhe deklarata noteriale e dëshmitarit – ka marrë edhe vendimin se çka pretendohet lidhur me provat shkresore ato nuk mund të provohen me dëshmitarë por ato mund të goditen për pavlefshmëri dhe jo të provohen me dëshmitarë, kjo referuar akteve të ekspertimit.

⁹⁸ Thirrjen e dëshmitarit për të provuar aktin e ekspertimit, si dhe ribërjen e aktit të ekspertimit.

235. Për sa më sipër, nuk janë evidentuar shkelje procedurale apo cenim të të drejtave të palëve nga ana e subjektit në procesin gjyqësor objekt denoncimi.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 18.6.2019, i shtetasit K. D.**

236. Shtetasi K. D. ka ngritur pretendimin se gjyqtarja është e korruptuar, pasi ka dhënë vendimin për pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2018, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, ndaj ish-regjistrueses së ZVRPP-së, znj. L. B.

237. Bashkëlidhur denoncimit, denoncuesi ka përcjellë dokumente lidhur me disa procese gjyqësore, administrative e penale, të ndjekura prej tij në të tria shkallët e gjyqësorit, lidhur me një pronë ku ai pretendonte të drejta reale.

238. Një ndër proceset ka qenë edhe kallëzimi i bërë prej tij ndaj një punonjëse të ZVRPP Tiranë, për të cilin Prokuroria ka kërkuar pushimin e procedimit. Kjo kërkesë është marrë për shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit Vjollca Spahiu, e cila me vendimin nr. ***, datë 26.4.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 14.1.2018, të Prokurorisë së Rrethit Tiranë, pasi fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 23.9.2019.

239. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nuk janë evidentuar shkaqe për thellimin e hetimit. Ky denoncues ka paraqitur edhe denoncime të tjera, të cilat janë marrë në shqyrtim nga Komisioni – dhe është konkluduar se ato nuk përmbushnin kriteret e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

6. Denoncimi nr. * prot., datë 19.6.2019, i shtetasit E. T.**

240. Denoncuesi ka pretenduar se babai i tij është dënuar për veprën penale “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, padrejtësisht pa asnjë provë, dhe se ngritja e akuzës nga organi i Prokurorisë është bërë qëllimisht për ta ndëshkuar atë.

241. Me vendimin nr. ***, datë 8.6.2010⁹⁹, subjekti ka deklaruar fajtor shtetasin R. T., për kryerjen e veprës penale dhe dënimin me 3 vjet burgim dhe me gjobë në masën 1 milion lekë. Ky vendim është pezulluar, me kushtin që gjatë kohës së provës i pandehuri të mos kryente vepër tjetër penale.

242. Vendimi në fjalë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 9.3.2011, me ndryshimin, “Prishjen dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit R. T., për akuzën “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, me arsyetimin se ishte provuar në mënyrë të pakundërshtueshme se akti objekt shqyrtimi gjyqësor kishte qenë i falsifikuar. Në këtë vendim ka rezultuar një shënim me përmbajtjen: “Vepra penale qëndron. Dokumenti i nënshkruar nga i pandehuri R. T. nuk pasqyron të dhëna të sakta për identitetin për të cilin është nënshkruar prej tij”.

243. Nisur nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika procedurale apo mangësi profesionale lidhur me dinamikën dhe veprimtarinë e subjektit në këtë çështje, pasi ankesa lidhet me themelin e çështjes ku Komisioni nuk mund të shprehet, për sa kohë nuk mund të zëvendësojë logjikën vlerësuese të provave e fakteve, objekt shqyrtimi, e cila është prerogativë (vetëm) e gjykatave më të larta.

7. Denoncimi nr. * prot., datë 28.10.2020, i shtetasit A. B.**

⁹⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 23.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

244. Denoncuesi ka pretenduar shkelje ligjore dhe cenim të të drejtave nga subjekti i rivlerësimit, e cila me vendimin nr. ***, datë 6.10.2020, kishte vendosur: *Mospranimin e kërkesës së shtetasit A. B. për përjashtimin e gjyqtarit B. H., si të pabazuar në ligj dhe në prova.*
245. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar¹⁰⁰ ka rezultuar se kërkuesi A. B. kishte kërkuar përjashtimin e gjyqtarit, pasi ai kishte zhvilluar seancën paraprake në mungesë të tij, duke mos e njoftuar.
246. Kërkesa për përjashtim është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, e cila me vendimin nr. *** regj. themeltar, datë 6.10.2020, ka vendosur: *Mospranimin e kërkesës penale-administrative me nr. *** Akti, datë 5.10.2020, me kërkues A. B., si të pabazuar në ligj dhe në prova.* Në këtë vendim, subjekti ka arsyetuar se nga shqyrtimi i akteve, konkretisht nga procesverbali i datës 2.10.2020, ora 12:30, ka rezultuar se kërkuesi ka qenë i pranishëm në seancë gjyqësore dhe ka paraqitur pretendimet e tij me shkrim, për rrjedhojë kërkesa e tij ishte e pabazuar. Ndaj vendimit të dhënë nga subjekti ka paraqitur rekurs kërkuesi A. B.
247. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. ***, datë 27.11.2020, ka çmuar se rekursi i paraqitur nuk kishte objekt, pasi gjyqtari për të cilin është paraqitur kërkesa për përjashtim është shprehur me vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën penale me objekt pushim i procedimit penal. Gjithashtu, Kolegji ka konstatuar se edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë kur ka shqyrtuar kërkesën për përjashtim të trupit gjykues nuk ka pasur objekt shqyrtimi, për sa kohë kërkesa për përjashtim është paraqitur në datën 5.10.2020, ndërsa gjyqtari i seancës paraprake është shprehur me vendimin përfundimtar nr. *** akti, në datën 2.10.2020.
248. Në përfundim të sa më sipër, pretendimet e denoncuesit lidhur me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, të shqyrtuar nga subjekti, kanë rezultuar të pabazuara. Sikurse është shprehur edhe Gjykata e Lartë, në vendimin e saj, nuk janë konstatuar problematika apo shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit.

8. Denoncimi nr. * prot., datë 1.11.2021, nr. *** prot., datë 10.11.2021, i shtetasit E. B.**

249. Denoncuesi ka pretenduar zvarritje të procesit, si dhe përjashtim nga salla e gjyqit nga subjekti, pa asnjë motiv. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar¹⁰¹, Komisioni konstatoi se çështja është shortuar në datën 15.4.2021, duke u caktuar subjekti si gjyqtare e seancës paraprake. Brenda afatit 5-ditor (sikurse përcakton pika 1/1 e nenit 332 “Caktimi i seancës paraprake” i Kodit të Procedurës Penale), në datën 20.4.2021 është lëshuar urdhri “Për caktimin e datës së seancës paraprake”, për t’u zhvilluar në datën 5.5.2021, me urdhërimin për njoftimin e prokurorit, të pandehurit dhe viktimës nga vepra penale, sipas neneve 332/a/1 dhe 332/b/1 të Kodit të Procedurës Penale. Me anë të fletëthirrjeve të datës 27.4.2021 janë njoftuar palët. Kjo seancë është shtyrë pasi nuk janë paraqitur as palët dhe as prokurori¹⁰².

¹⁰⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2023.

¹⁰¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2023.

¹⁰² Katër seancat e para paraprake (data 5.5.2021; 20.5.2021, 2.6.2021 dhe 16.6.2021) nuk janë zhvilluar për shkak të mungesës së Prokurorit për shkaqe ligjore (pezullimit nga detyra për shkak të vendimit të shkarkimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit). Mbi njoftimin e Drejtuesit të Prokurorisë, zëvendësimi i Prokurorit të çështjes është bërë në seancën e datës 5.7.2021. Dy seancat e tjera paraprake (data 23.7.2021 dhe 22.9.2021) janë shtyrë për shkak të mungesës së të tre

250. Në procesverbalin e datës 2.6.2021 është cituar se i pandehuri E. B. ka shfaqur sjellje demonstrative dhe ka prishur solemnitetin e gjykimit për të cilat e, për rrjedhojë, Gjykata ka marrë vendim për largimin e tij nga salla e gjykimit duke e paralajmëruar atë për gjobë. Janë zhvilluar gjithsej 6 seanca paraprake nga të cilat: 4 janë shtyrë pasi prokurori i caktuar ishte shkarkuar nga detyra, dy seanca për përsëritjen e njoftimit të palëve.
251. Me vendimin nr. ***, datë 5.10.2021, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit. Dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. ***, në ngarkim të të pandehurit E. B.
252. Komisioni ka konstatuar se nuk është respektuar parashikimi i nenit 332, pika 1.1 e Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit seanca përgatitore përcaktohet brenda 5 ditëve nga depozitimi i kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim. Po ashtu, referuar pikës 3 të dispozitës së sipërcituar, është konstatuar se nuk është respektuar afati 30-ditor për dërgimin e çështjes në gjyq.
253. Lidhur me konstatimet e mësipërme, e pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 6, në lidhje me afatin, brenda të cilit duhet caktuar seanca paraprake, subjekti ka shpjeguar se neni 332, pikat 2 dhe 332/a, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale kanë një parashikim kontradiktor mes tyre, pasi i pari (neni 332/2) përcakton se: *“Nga data e depozitimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, deri në datën e seancës nuk duhet të kalojë një afat më i gjatë se 10 ditë”*, ndërsa i dyti (neni 332/a/3) parashikon se: *“Njoftimet sipas paragrafëve 1 dhe 2 duhet të bëhen të paktën dhjetë ditë para datës së seancës”*. Për t’u treguar sa më garantist në favor të së drejtës së të pandehurit për mbrojtje efektive dhe dhënia e një kohe të arsyeshme për këtë qëllim, seanca është caktuar për t’u zhvilluar 15 ditë nga momenti i nxjerrjes së urdhrit për caktimin e seancës gjyqësore. Në këtë mënyrë është përpjekur si për t’u garantuar e drejta e mbrojtjes, ashtu edhe eficientia e shpejtësia në gjykim.
254. Për sa i përket afatit tërësor të shqyrtimit të kërkesës, subjekti ka sqaruar se: *“Megjithëse neni 332, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj”, në rastin konkret, kanë ekzistuar shkaqe që kanë penguar plotësisht mundësinë e disponimit. Sipas nenit 332/b, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale “Verifikimi i paraqitjes së palëve”, “seanca zhvillohet me dyer të mbyllura, me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit”. Duke mos u siguruar pjesëmarrja e prokurorit në katër seancat e para paraprake e as e të pandehurit e mbrojtësit të tij në dy seancat e mëpasshme, kanë kushtëzuar përfundimin e gjykimit brenda afatit 30-ditor. Mosrespektimi i domosdoshmërisë së pranisë së prokurorit në seancën paraprake do të prodhonte një vendimmarrje absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 128/a, pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, prandaj edhe*

subjekteve në seancën e parë (prokurori, i pandehuri dhe viktimja). Ndërsa në të dytën (22.9.2021), për shkak të pushimeve e lejes verore, mbi qëndrimin edhe të prokurorit, janë përsëritur njoftimet për të pandehurin dhe viktimën, duke u njoftuar edhe në adresat e *emailit* dhe numrat e telefonit që kishin përcjellë në sekretarinë gjyqësore. Në seancën e datës 5.10.2021, pasi ishte prezent prokurori, në mungesë të të pandehurit, por konfirmuar dijeninë përmes *emailit*; në prani të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht nga gjykata dhe në mungesë të viktimës dhe avokatit të tij, i cili megjithëse kishte dijeni nuk ishte paraqitur në gjykim, subjekti ka vendosur kalimin e çështjes në gjykim.

respektimi formal i afatit të sipërcituar, nuk do të ishte efektiv në substancën e tij e do të prodhonte një proces jo të rregullt ligjor e, për më tepër një vendimmarrje nul¹⁰³”.

255. Në përfundim të analizimit të shpjegimeve të subjektit, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe të paraqitur nga subjekti, sa i takon procedurës së gjyqimit është konstatuar se subjekti ka qenë në pamundësi për të proceduar brenda afatit 30-ditor të përcaktuar nga neni 332, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas nenit 332/b të këtij Kodi.

9. Denoncimi nr. * prot., datë 4.12.2018, i shtetasit A. J.**

256. Denoncuesi nuk ka parashtruar ndonjë shkelje procedurale të mundshme të kryer prej saj, por është shprehur se: *“Për vendimin nr. ***, datë 13.6.2011, të dhënë prej gjyqtarës V. Spahiu, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 29.4.2013, ka lënë disa detyra për zbatim”.*

257. Me anë të këtij vendimi¹⁰⁴, subjekti kishte vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit datë 12.10.2010, lidhur me kallëzimin penal nr. ***. Në vijim, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 29.4.2013, ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 13.6.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, duke e prishur vendimin e mosfillimit të datës 12.10.2010 të Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Kukës dhe kthimin e akteve për vazhdimin e veprimeve mëtejshme hetimore.*

258. Pasi ka kryer veprimet përkatëse hetimore, Prokuroria ka vendosur pushimin e çështjes penale, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. ***, datë 21.7.2017, ka arsyetuar se Prokuroria duhet të kryente detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 29.4.2013, konkretisht ballafaqimi mes kallëzuesit A. J. dhe të kallëzuarit prej tij, si dhe kryerja e ekspertimit inxhinierik topografik në grup.

259. Më pas, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka kryer veprimet hetimore bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit – dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. *** (***) , datë 2.10.2018, ka vendosur: *Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak se fakti penal nuk ekziston. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kallëzuesi A. J., i cili ka kërkuar: “Ndryshimin e vendimit dhe kthimin e akteve për vazhdimin e veprimeve të mëtejshme hetimore nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës”. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 29.10.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër.*

260. Shtetasi A. J. ka paraqitur rekurs lidhur me të cilin Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 11.7.2023, ka arsyetuar se: *“ ... gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrim të njëjtë lidhur me ankimin e paraqitur nga kërkuesi, të bazuar në nenin 329/1 të KPP, me objekt kundërshtimin e vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal, duke disponuar me rrëzimin e saj. Gjykatat e faktit në unison kanë konkluduar se nga organi i akuzës janë ezauruar të gjitha veprimet procedurale që i ngarkon ligji procedural penal, lidhur me*

¹⁰³ Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave dosjen e procesit gjyqësor për çështjen nr. ***, datë regjistrimi 15.4.2021, i gjyqtarit të seancës paraprake, si dhe vendimi nr. ***, datë 1.2.2022, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mbi themelin e gjyqimit.

¹⁰⁴ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2023, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës.

*provueshmërinë e faktit penal të pretenduar nga kallëzuesi si dhe ato të lëna detyrë nga vendimi ***, datë 29.4.2013, i Gjykatës së Apelit Shkodër”. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pasi nuk evidentohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit penal material, i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.*

261. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, përveç sa ka shpjeguar edhe ka paraqitur vendimin nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, vendimin nr. *** të Gjykatës së Apelit Shkodër, si edhe vendimin nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.
262. Gjithashtu, lidhur me çështjen në fjalë, denoncuesi ka paraqitur ankesë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky i fundit, me vendimin nr. *** prot., datë 16.3.2023, ka disponuar me arkivimin e çështjes/ankesës¹⁰⁵.
263. Për sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika procedurale apo mangësi profesionale lidhur me dinamikën dhe veprimtarinë e subjektit në këtë çështje, sikurse edhe nga hetimi administrativ i kryer nga ILD-ja, nuk janë konstatuar shkelje të subjektit në çështjen objekt denoncimi.

10. Denoncimi nr. * prot., datë 30.7.2018 dhe denoncimi nr. *** prot., datë 18.7.2018 i shtetasit Sh. H.**

264. Denoncuesi ka përmendur disa prokurorë dhe gjyqtarë, ndërmjet tyre edhe subjektin e rivlerësimit Vjollca Spahiu, lidhur me vendimin nr. *** regj., datë 2.10.2015, të dhënë nga subjekti, me objekt “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 20.5.2015”. Me anë të këtij vendimi, sikurse edhe prokurori i çështjes, subjekti ka arsyetuar se fakti i kallëzuar nga ky shtetas është hetuar më parë nga ana e organit të prokurorisë, është ankimuar dhe është zgjidhur me vendim të formës së prerë¹⁰⁶. Për rrjedhojë, për sa kohë faktet e rrethanat ishin gjë e gjykuar, është respektuar parimi i përgjithshëm i të drejtës penale, i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*).
265. Vendimi i mësipërm, i dhënë nga subjekti, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 2.12.2016. Ndërsa Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 9.6.2022, nuk ka pranuar rekursin e paraqitur prej tij.
266. Në përfundim, nuk janë konstatuar problematika procedurale apo mangësi profesionale lidhur me dinamikën dhe veprimtarinë e subjektit në këtë çështje.

11. Denoncimi nr. * prot., datë 10.10.2023, i shtetas F. G.**

267. Denoncuesja ka ngritur pretendime në lidhje me çështjen penale nr. ***, viti 2022, ku ajo ka qenë e pandehur, duke ngritur pretendime lidhur me mënyrën e saj të komunikimit në sallën e gjyqit. Kjo çështje ka qenë e shqyrtuar më parë në të tria shkallët e gjyqësorit dhe është rikthyer për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku janë zhvilluar 28 seanca.
268. Me qëllim verifikimit të pretendimeve të denoncueses, Komisioni ka administruar kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore të çështjes objekt denoncimi, si dhe ato në versionin audio. Nga shqyrtimi i tyre është konstatuar se pothuajse në të gjitha seancat gjatë momentit të verifikimit të palëve nga gjykata apo gjatë pyetjes së dëshmitarëve, e

¹⁰⁵ Me arsyetimin se ankesa e shtetasit A. J. nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë duke vendosur arkivimin e saj.

¹⁰⁶ Vendimi nr. ***, datë 2.10.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

pandehura ka ndërhyrë pa iu dhënë e drejta e fjalës nga gjykata. Subjekti i ka kërkuar çdo herë të mos fliste, për shkak të momentit procedural jo të duhur. Gjithashtu, i ka bërë me dije denoncueses se ndërhyrjet e vazhdueshme të saj kanë sjellë prishjen e rregullit dhe solemnitetit në gjykim, duke e paralajmëruar për masë administrative. Në kushtet kur, me gjithë paralajmërimet në vazhdimësi nga ana e subjektit, e pandehura nuk i është bindur gjykatës, kjo e fundit ka urdhëruar nxjerrjen e saj nga salla, madje shpesh herë edhe nëpërmjet punonjësit të policisë.

269. Nga seancat audio¹⁰⁷, si dhe nga shqyrtimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, nuk janë evidentuar shkelje të etikës nga ana e gjyqtarës Vjollca Spahiu.
270. Për sa më sipër, ky denoncim nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, nuk mund të merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit dhe, kësisoj, pretendimet e subjektit kanë rezultuar të pabazuara.

LIDHUR ME DISA FAKTE TË BËRA PUBLIKE NGA MEDIA

271. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është vënë në dijeni lidhur me publikimet në median *online*, ku përmendej subjekti i rivlerësimit. Nga analizimi i tyre është konstatuar sa vijon:

1. Lidhur me artikullin e publikuar nga *¹⁰⁸**

272. Në këtë artikull, ndër të tjera citohet se: *“Gjatë gjykimit, vepra penale ka ndryshuar nga vrasje me paramendim në “Vrasje me dashje”, e cila ka një dënim nga 10 deri në 20 vite burg. Gjykata nuk mori parasysh precedentët e autorit apo edhe fshehjen e viktimës. Në fund e dënoi me 10 vite burg. Madje, dënimin ta kryejë në një burg të sigurisë së zakonshme, çka i hap rrugë për ulje dënimi dhe lirim me kusht. Gjykata shkruan se kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit. Por, pavarësisht se vepra penale u ndryshua në gjykatë, prokurori i Tiranës nuk e ankimoi në Apel”*.
273. E pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka sqaruar se artikulli i mësipërm i referohet çështjes penale që i përket të pandehurit F. Rr. etj. Referuar akteve të përfutuara gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe të marra në gjykim sipas rritit të gjykimit të shkurtuar, gjykata (me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, anëtare e së cilit ka qenë edhe subjekti) ka krijuar bindjen se fakti penal duhet të kualifikohej si “Vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe jo si “Vrasje me paramendim”, sikurse kishte kërkuar Prokuroria. Me arsyetimin dhe me disponimin e gjykatës ka qenë dakord edhe organi i akuzës, për sa kohë prej këtij të fundit nuk është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Subjekti ka paraqitur një kopje të vendimit gjyqësor nr. ***, datë shpallje 5.7.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë¹⁰⁹, në ngarkim të shtetasve F. Rr. dhe P. Rr. Të tre anëtarët e trupit gjykues kanë konkluduar në vendimmarrje unanime, duke vlerësuar se veprimet e të pandehurit në raport me faktin e ndodhur nuk

¹⁰⁷ Seancat janë transkriptuar në një dokument veçmas, nëse do të nevojiten.

¹⁰⁸ https://***.tv***/

¹⁰⁹ Si dhe shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; vendimin gjyqësor nr. ***, datë 5.7.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (me shënimet e sekretarisë gjyqësore); shkresa nr. *** prot., datë 18.3.2024, e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; vendimi nr. *** akti, datë 19.9.2023, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (së bashku me shënimet e sekretarisë mbi historikun gjyqësor-procedural të tij);

konfigurimin dhe as provonin elementin e paramendimit, sikurse kishte konkluduar prokurori gjatë fazës së hetimeve paraprake¹¹⁰. Caktimi i dënimit është bërë brenda marzheve për secilën vepër të kryer e, në përfundim, është aplikuar zbritja e 1/3 së dënimit. Ulja e dënimit përfundimtar nga 15 në 10 vite burgim është bërë në bazë të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale.

274. Subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga e cila ka rezultuar se: *Me vendimin nr. ***, datë 19.9.2023, Gjykata e Posaçme, për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal lidhur me ankimin e shtetasit Xh. H. për mënyrën e hetimit e më pas gjykimin të çështjes penale, me viktimë Rr. H., për të cilin ishte arritur në konkluzionin se “fakti i kallëzuar nuk ekziston” e, në këto kushte, ankimi është rrëzuar.*
275. Ndaj vendimit të sipërcituar është ushtruar ankim vetëm nga shtetasit Xh. H. (babai i viktimës së veprës penale) dhe E. H. (trashëgimtar i viktimës). Nga prokurori nuk është ushtruar ankim. Dosja është dërguar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë më 11.9.2023. Vendimi nr. ***, datë 5.7.2023, i Gjykatës ka marrë formë të prerë për të pandehurin P. Rr., pasi nuk është ankimuar.
276. Nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika procedurale apo mangësi profesionale lidhur me veprimtarinë e subjektit në këtë çështje.

2. Lidhur me një tjetër artikull të publikuar nga *¹¹¹**

277. *** ka publikuar një artikull, ku, ndër të tjera, citohej: *“Gjatë seancës me dyer të mbyllura, gjyqtarja Vjollca Spahiu e liroi të dyshuarin duke e dërguar nën arrest shtëpiak. Në gjykatë u deklarua se kontrolli u kërkua nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me mbështetjen e policisë gjyqësore pas dyshimeve se në magazinat e 65-vjeçarit grumbullohej dhe shitej verë pa pullën fiskale”.*
278. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 4, subjekti ka parashtruar se ajo ka qenë gjyqtare e hetimeve paraprake dhe me vendimin nr. ***, datë 9.4.2022, me objekt “Vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit”, ka disponuar për vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, sipas nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale, sikurse ishte kërkuar nga prokurori. Vendimi në fjalë ka marrë formë të prerë më 21.4.2022. Lidhur me kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë, subjekti ka parashtruar se pasi janë analizuar kriteret e arrestit në flagrancë, në bazë të dispozitave të neneve 251, 252 dhe 259 të Kodit të Procedurës Penale, nga ana e saj është disponuar me vleftësimin e ligjshëm të arrestit, pasi nga policia gjyqësore ishin respektuar kriteret imperative ligjore në lidhje me arrestin në flagrancë të personit nën hetim, konform nenit 259, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale¹¹².
279. Për sa i përket kërkesës së dytë, që lidhej me caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues, subjekti ka sqaruar se nga ana e saj janë vleftësuar kriteret e

¹¹⁰ Konkretisht: shoqërimi permanent i autorit me viktimën; mungesa e ndonjë konflikti më të hershëm të tyre; mosverifikimi i ndonjë rrethane tjetër që të provonte krijimin e kushteve konkrete ideore dhe logjistike për ta konfiguruar veprën e kryer si me paramendim, e bënin të pabazuar pretendimin e organit të akuzës për ta kualifikuar faktin si “Vrasje me paramendim”.

¹¹¹ https://*****/

¹¹² Subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; vendimin gjyqësor nr. *** regj. them., datë 9.4.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (me shënimet e sekretarisë gjyqësore).

përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e një mase sigurimi, duke mbërritur në konkluzionin se plotësoheshin kushtet për caktimin e një të tille (masë sigurimi personal). Përpos përshtatshmërisë së saj, gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, edhe në eventualitetin kur çmon se duhet caktuar një masë më e rëndë sigurimi.

280. Në këto kushte, nga gjykata rezulton të jenë pranuar të dyja kërkesat e prokurorit sipas objektit, duke u vleftësuar i ligjshëm arresti në flagrancë i personit në hetim dhe caktuar masa e kërkuar nga akuza, ajo e “Arrestit në shtëpi”, sipas nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale. Ndaj vendimit të sipërcituar nuk është ushtruar ankim nga asnjë prej palëve e, për rrjedhojë, ka marrë formë të prerë.
281. Në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar, si dhe referuar kuadrit ligjor rregullator, konkretisht pikës 3 të nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale, Komisioni nuk konstaton problematika procedurale apo mangësi profesionale lidhur me dinamikën dhe veprimtarinë e subjektit në këtë çështje.

3. Në lidhje me një informacion¹¹³ mbi kallëzimin e shoqatës “*” ndaj disa magjistratëve**

282. Komisioni është vënë në dijeni lidhur me një kallëzim të bërë ndaj subjektit dhe një prokurori nga shoqata “***”, me objekt “Shpërdorim detyre” të kryer në bashkëpunim. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se çështja në fjalë (për të cilën është kallëzuar subjekti), pasi është hetuar nga prokurori O. D., në datën 13.7.2015, është dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo çështje fillimisht i është caktuar gjyqtarës Vjollca Spahiu, e cila ka paraqitur një kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes *de qua*. Kjo kërkesë është pranuar dhe, për pasojë, gjykimi i kësaj çështjeje ka vijuar nga një tjetër gjyqtar. Rrjedhimisht, nuk ka pasur asnjë akt, veprim, shqyrtim apo gjykim të subjektit në këtë çështje.
283. Lidhur me kallëzimin e bërë nga shoqata “***”, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti vuri në dispozicion vendimin e datës 30.3.2016, për “Mosfillimin e procedimit penal”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ndaj shtetasve O. D. me funksion prokuror dhe Vjollca Spahiu me funksion gjyqtare, për konsumimin e veprës penale “Shpërdorim detyre” të kryer në bashkëpunim.
284. Po ashtu, subjekti ka paraqitur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 31.3.2016, të marrë nga një tjetër subjekt rivlerësimi.
285. Nisur nga sa më sipër është përshkruar, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika procedurale apo mangësi profesionale të subjektit, për sa kohë çështja në fjalë nuk është shqyrtuar prej saj.
286. Në konkluzion përfundimtar lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk është konstatuar mangësi profesionale, mosrespektim i të drejtave të palëve apo mangësi në arsyetimin e vendimeve të dhëna prej saj. Në këto kushte, znj. Vjollca Spahiu vlerësohet me një nivel profesional bindshëm kualifikues.

KONKLuzion Përfundimtar

¹¹³ Bëhej fjalë për një publikim në facebook në linkun:
https://www.facebook.com/****/

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Vjollca Spahiu:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Vjollca Spahiu, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 28.6.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana